

# HEJZA



**Burhan AHMETI**

***PËRFITUAN ARTISTËT QË ISHIN AFËR PUSHTETIT***

Nën thjerrë

# SHTIREMI SIKUR PO BËJMË KULTURË

Sa është e kulturuar ministria për kulturë. Në fakt, duhet shtruar pyetja: sa jemi të kulturuar, kur do të kulturohet shoqëria? Me politika kulturore që i shohim nëpër viset tona si dhe më gjerë, mjerisht, do të duhet një kohë e gjatë, atëherë kur politika do të bëhet "njësi mësimore" e kulturës! Deri atëherë, ia vlen të shtiremi se po bëjmë kulturë!



**Nga Avni HALIMI**

Sa është e kulturuar ministria për kulturë? Nuk shtrohet pyetja këtu për kulturën e punës që duhet ta ketë administrata e kësaj ministrie, por, sa kjo administratë e njëjshme kulturën! A e percepton kjo ministri kulturën si "pasqyrë e shpirt" të një populli, e trashëguar që kur di për vete populli! Institucionet, por edhe subjektet fizike, të cilët janë të përfshirë drejtpërdrejt në zhvillime të kulturës së një populli, në fakt, duhet të llogariten si "opozita më e pabindur" e një populli në raport me pushtetet politike. Krijuesit, artistët, kulturë-bërësit, janë ana tjetër e medaljes së një komuniteti të gjerë të angazhuar në bërjen e shtetit, në ruajtjen dhe në lartësimin e tij! Kjo kategori e shoqërisë, përgjatë historisë së njerëzimit, shpesh ka ditur të përplasat me pushtete dhe përplasjet e tilla kanë rezultuar fatale për mbretërit e qeverit!

Pra, ministria e kulturës është "e shpikur" si dikaster për të qenë servis që përafrohet interesat e pushtetit politik me interesat e kulturës si "pushtet" më vete! Nuk është ky dikaster që t'ia rregullojë imazhin kulturor një qeverie, nuk është as për ta ushtruar një politikë të caktuar të pushtetit mbi artistë, krijues e kulturë-bërës! Pa dyshim, ministria e kulturës në kuadër të një qeverie popullore mbase është segmenti kontrollues i buxhetit të caktuar nga qeveria, të përcjellë mënyrën e shpenzimit të fondeve të dedikuara për projektet që i kanë kërkuar institucionet apo subjektet e ndryshëm fizik.

Nga ana tjetër, ministria për kulturë është paramenduar si "altoparlant" i shqetësimeve, i kërkesave, i interesave të artistëve

dhe krijuesve; ministria e kulturës duhet të jetë "avokat" dhe t'i avokojë të gjitha shqetësimet kulturore në qeverinë e vet! Ministria e kulturës duhet të dijë edhe të reagojë, madje edhe të ankohet publikisht për politikën e gabuara apo të mangëta kulturore të qeverisë. Duhet të protestojë, apo, të paktën të jetë bartëse e reagimeve dhe protestave të krijuesve, artistëve si dhe komunitetit tjetër të angazhuar në fusha të ndryshme kulturore (muze, biblioteka, institucione të trashëgimisë kulturore etj.) Vetëm një situatë e tillë do të mund të dëshmonte se ministria e kulturës është e kulturuar. Prandaj, në mungesë të këtyre situatave, fare lehtë konstatohet se ministria e kulturës është, në fakt, dikaster i politizuar apo, për më keq, i partizuar.

Ministria e kulturës, e zhveshur nga petku politiko-partiak, do t'i evidentonte të gjitha nevojat e institucioneve kulturore, kostot vjetore të tyre, kërkesa e tyre, projektet e parapara për aktivitete dhe zhvillim kulturor. Gjithsesi, një segment shumë i rëndësishëm është edhe sektori civil, i cili, në të shumtën e rasteve vjen me alternativa të shumta kulturore, me aktivitete përtej atyre institucionale dhe, ministria e kulturës në tavolinën e qeverisë duhet të përplasë një "dosje" të paimagjinueshme për politikën dhe politikanët dhe, veç tjerash, duhet t'i sensibilizojë dhe t'i bidnë t'i pranojnë kërkesë për kërkesë (racionale, të arsyeshme) të shtruar nga komunitetet e ndryshëm të angazhuar në kulturë!

Shikuar nga këndi i interesave të artistëve dhe krijuesve, për sa u tha më sipër, tingëllon bukur e mirë! Por, megjithatë, promotori i një qëndrimi të prerë të ministrisë për

kulturë, duhet të jenë vetë artistët e krijuesit! Deri më sot, nuk është dëgjuar të ketë ndodhur ndonjë rast që flet për rebelimin e krijuesve dhe artistëve kundër modelit politiko-partiak të ministrive të kulturës që i kemi pasur! E kemi pasur të kundërtën! Ministria e kulturës është përdorur si "kërbaç" me të cilën qeveritë e ndryshme i kanë mbajtur të disiplinuar kulturë-bërësit, mbi të cilët, është ushtruar politika akulturore e qeverive, të cilët, çuditërisht buxhetin e ndarë për kulturë e llogarisen si veprimin më të padëshiruar që shkakton një kosto "të panevojshme"! Reagime artistësh e krijuesish gjithnjë ka pasur për buxhet të vogël, për financime qesharake të projekteve, për kalim të pak projekteve dhe, asnjëherë nuk ka pasur për politika të gabuara kulturore, të varfra, tendencioze apo edhe diskriminuese. Ndaj reagimeve banale, qeveritë kanë ditur të përgjigjen banalisht dhe, në të tilla "banalitete" gjithnjë ka pësuar kultura! Këtu dhe bije poshtë pyetja e shtruar qysh në fillim: sa është e kulturuar ministria për kulturë. Në fakt, duhet shtruar pyetja: sa jemi të kulturuar, kur do të kulturohet shoqëria? Me politika kulturore që i shohim nëpër viset tona si dhe më gjerë, mjerisht, do të duhet një kohë e gjatë, atëherë kur politika do të bëhet "njësi mësimore" e kulturës! Deri atëherë, ia vlen të shtiremi se po bëjmë kulturë!

#### Politika nacionale për diversitet kulturor

Për rreth dyzet vite me radhë shqiptarët zhvilluan kulturë bazuar në ideologjinë komuniste, kurse shqiptarët jashtë atdheut e në viset e tyre etnike patën fatin të përjeto-

jnë edhe diskriminimin kulturor si rrjedhojë e qëndrimeve getoizuese kundër shqiptarëve vlerat shpirtërore e kulturore të të cilëve i konceptonin si motiv të sigurt për "shovinizëm dhe separatizëm"!

Në Shqipëri e Kosovë, edhe më tej kultura zhvillohet nën prizmin e përkatësisë politike, pa ndonjë platformë "të shenjtë" mbi të cilën do të ngrihej një politikë e përhershme kulturore së cilës do t'i nënshtrohej çdo pushtet e çdo qeveri!

Në shtetet e tjera ku jeton në masë të konsiderueshme bashkësia etnike shqiptare, politikën kulturore shtetërore janë gati po ato të sistemit komunist e me elemente të aparthejdit! Nëpër organizata të larta të BE-së janë miratuar një sërë rezolutash kundër diskriminimit kulturor e kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, por edhe rezoluta që i kanë dënuar këto diskriminime dhe shkelje të të drjtave të përgjithshme nga ideologjitë diktatoriale. Ka miratuar edhe shteti shqiptar, edhe Kosova por, sa këto rezoluta shtetërore kanë ndihmuar në dekomunistizimin e kulturës shqiptare! Cili është raporti i pushtetit karshi intelektualëve të kyçur nëpër parti që i bëjnë karshillëk pushtetit?! Cili është qëndrimi i pushtetit ndaj Akademive, ndaj institucioneve arkeologjike, antropologjike, ndaj institucioneve nacionale që kultivojnë veprimtari të ndryshme artistike! Mbase sot nuk e përjetojnë atë izolim e "përndjekje shtrigash", por, diferencimin ideo-politik gjithësesi që e vuajnë deri në heshtje totale dhe në hejje dorë nga veprimtari të intelektualëve! Për fatet e identitetit kulturor si dhe të zhvilli-

meve kulturore vendosin artistët e krijuesit, arkeologët e artistët e veprimtarive skeniko-muzikor, dhe nuk duhet të vendos pushteti! Kultura të njëjtin fat komunist po e përjeton edhe në Kosovë ndonëse nuk e ka presionin e diskriminimit nga okupatori i dikurshëm! Identiteti kulturor i shqiptarëve të viseve etnike edhe pas tri dekadave demokraci, edhe më tej shikohet nga i njëjti prizëm diskriminues dhe nga të njëjtat aparthejd-politika! Shoqëria serbe, malazeze dhe maqedonase, nuk kanë punuar fare në çrrënjosjen e urrejtje etnike kundër çdo vlere shqiptare. Angazhimi shtetëror i tyre në zhvillimin e multikulturalizmit si dhe në ruajtjen e diversiteteve kulturore konsiston vetëm në faktin që për shqiptarët mjafton që frymojnë shqip dhe që, identitetin kulturor të tyre e shprehin brenda mureve të shtëpisë. Asnjëherë nuk u trajtuan si viktimë kolektive e komunizmit etnik serb, malazezë e maqedonas, asnjëherë nuk iu kërkua shqiptarëve falje kolektive dhe asnjëherë nuk u stimuluan kolektivisht serbët, malazezët e maqedonasit për t'u njoftuar sa më masovikisht me kulturën shqiptare si një prej kulturave më të vjetra në rajon e më gjerë; në shenjë pendimi për tërë atë diskriminim dhe urrejtje që e kanë kultivuar kundër kulturës shqiptare, është dashur që ta mësojnë, të paktën, si lëndë fakultative, me qëllim që ta kenë sa më të lehtë dhe etnikisht më të pranueshëm institucionalizimin e jetës kulturore shqiptare. Asnjë qeveri në Mal të Zi, në Serbi e në Maqedoninë e Veriut nuk insistuan që të krijojnë buxhet special për institucionalizimin e kulturës shqiptare dhe, kësajsoj të dëshmojnë se janë shtet model për ruajtjen dhe kultivimin e diversitetit kulturor. Ligjet e natyrës nuk mund të përvetësohen e të përkthehenin si ligje shtetërore. Prezenca e etnitetit shqiptar në Maqedoninë e Veriut, në Serbi e Mal të Zi nuk është vullnet i qeverive të këtyre shteteve por është ligj i natyrës. Aktivitetet private kulturore, aktivitetet kulturore të zhvilluara me ndihma e me sponsor nga firmat private nuk janë angazhime shtetërore për diversitet kulturor. Majorizimi

etnik-kulturor nuk është asgjë tjetër përveçse recidiv i komunizmit. Edhe për faktorin ndërkombëtar kjo hipokrizi duhet të jetë brengosëse, sepse, këta shtete, në emër të "multikulturalizmit" dhe "diversitetit kulturor" përfitojnë para të majme. Ndërkombëtarët duhet ta studiojnë mirë realitetin e sotëm e të kuptojnë se, përse shqiptarët, populli me kulturë më të lashtë në rajon, ka ngelur shekuj mbrapa, nuk e ka të institucionalizuar kulturën, nuk e ka platformën kombëtare për një identitet kulturor të respektueshëm prej të gjithëve! Pse shqiptarët e viseve etnike nuk kanë arkeologë, antropologë, regjisorë filmi, pse universitetet e tyre nuk kanë fakultete kulturologjike, restorues, konservues etj! Nëse dikur "moti" këtë diskriminim e ushtruan në emër të ideologjisë komuniste dhe në emër të luftës kundër "shovinizmit dhe separatizmit" të kulturuar, sot çfarë po ndodhë? Në emër të çkafit jeta kulturore shqiptare është e po atij niveli të periudhës komuniste, nëse jo edhe më keq! Kultura shqiptare sa më parë dhe në të gjitha dimensionet duhet të institucionalizohet kurse politikave kulturore duhet urgjentisht të dekomunistizohen. Shqipëria dhe Kosova, si shtete shqiptare, nëse nuk kanë kapacitete për ta hartuar platformën gjithëkombëtare për përfortimin dhe zhvillimin e identitetit kulturor, le të angazhohen ekspertë ndër-kombëtarë dhe le të konsolidojnë komunitet të fuqishëm lobistësh për të ndikuar te shtetet post-komuniste (ku jetojnë në masë të konsiderueshme shqiptarët) që pa hezitim të heqin dorë nga diskriminimi kulturor duke e institucionalizuar sa më masovikisht kulturën shqiptare nëpër shtetet përkatëse.

**Diskriminimi demokratik edhe më i rëndë se ai komunist**

Si zhvilloheshin kulturalisht shqiptarët e Maqedonisë së Veriut pas Luftës së Dytë Botërore e deri në shpërbërje të ish-Jugosllavisë? Cila ishte pozita e tyre kulturore? Cili ishte qëndrimi i politikës zyrtare ndaj kulturës shqiptare? Cilat

ishin politikave kulturore dhe sa ato politika i preknin interesat kulturore të shqiptarëve? Gjatë periudhës komuniste, si gjithandej nëpër ish-Jugosllavi, edhe në Maqedoni shqiptarët kaluan nëpër një proces të tmerrshëm diskriminues. Përjetuan presione të papërbalueshme politike dhe për pasojë u detyruan të shpërngulen mijëra familje shqiptare fillimisht nëpër viset turke e pastaj edhe nëpër shumë qendra evropiane. Krahas këtyre represalieve, sistemit jugosllav i duhej edhe propagimi i "bashkim-vëllazërimit" i cili ruhej dhe kalitej përmes ventillimeve kulturore amatoreske të rezervuar për "kombësitë", term ky i shpikur për bashkësitë etnike të cilat sistemi jugosllav nuk i llogariste për komb. Kombësitë llogariteshin si elementë që e pasuronin diversitetin kulturor të republikës ku banonin. Pra, kultura e një republike ishte e pasur edhe për një kulturë tjetër që i përkiste një kombësie që nuk mund të llogariste në shtetëf-ormësim. Kultura e republikës, apo e popullit shtetë-formues, avansohej, stimulohesh, subvencionohej, me politika, me plane zhvillimi e me buxhet shtetëror e republikan, ndërsa kultura e kombësive "ruhej e konservuar", mbahej ashtu siç ishte që në hapat e para të formimit të shtetit jugosllav. Kjo në planin e politikës federale, ndërsa në planet e politikave republikane situata ishte edhe më e mjerueshme. Racizmi kulturor dukej si në ditë me diell! Diskriminimi federativ u jepte leje republikave për hartime dhe zbatime të politikave edhe më diskriminuese kulturore. Kapacitetet intelektuale e krijuese të shqiptarëve të Maqedonisë së atëhershme ishin të pakta dhe gjithnjë të survejuara nga "syri i zgjuar" që kishte për detyrë kapjen e nacionalistëve dhe shovinistëve shqiptarë. Pra, censura, autocensura dhe "syri i zgjuar", elemente këto të pushtetit të egër diktatorial, ndikonin në vetëpërmbytje intelektuale dhe, për pasojë, në jetën skajshmërisht të varfër kulturore. Pushteti totalitar kishte edhe një mjet tjetër, i cili duke u llogaritur më tepër si atrakcion kulturor, shtonte rehatinë e vet politike duke e trashur

"bashkim-vëllazërimit". Për të gjitha kombësitë në rrafshin kulturor stimulon-te themelimin e shoqërive kulturo-artistike, prej të cilëve kërkonte repertor që do ta pasqyronte diversitetin kulturo-folklorik të kombësive. Këtë politikë zyrtare ishte e detyruar të zbatonte edhe SHKA "Ibe Palikuqi" dhe "Emin Duraku" nga Shkupi, "Xheladin Zeqiri" nga Tetova, "Bajram Shabani" nga Kumanova, e ndonjë tjetër të nivelit skajshmërisht amatoresk. Asnjë nga këto shoqëri kulturo-artistike shqiptare nuk mund të organizonte program kulturo-artistik për shqiptarët e këtuashëm pa marrë leje nga policia e vendit. Fillimisht dorëzoheshin tërë repertori i përkthyer dhe i shpjeguar në gjuhën maqedonase dhe tek pastaj, nëse kalonte "gjyotinën" e përshtatshmërisë ideo-politike, nëse repertori ngërthente edhe pikë artistike nga kombësitë e tjera, qoftë këngë apo valle, sigurohej leja për ndonjë koncert amatoresk. Dhe kjo ishte e tërë jeta kulturore shqiptare në Maqedoni e dikurshme, nivelin e të cilës e ngriste paksa në profesionalizëm vetëm trupa teatrore e shqiptarëve që funksiononte në kuadër të Teatrit të kombësive në Shkup. Sot në Maqedoninë e Veriut është edhe më keq! Nëse dikur kulturën shqiptare në këtë shtet e ngulfaste sistemi politik, sot këtë e bën kombi maqedonas. Diskriminimi dhe mohimi i kulturës shqiptare sot për sot është jo vetëm strategji apo program por, obligim dhe detyrë kombëtare maqedonase, e mbështetur në korniza të ndryshme ligjore. Kryeministri maqedonas, me rastin e përgatitjeve për ndryshime kushtetutare, sapo tha: "Nuk e kemi prioritet heqjen e 20%, prioritet e kemi futjen e 3500 bullgarëve në Kushtetutë." Kultura shqiptare, gjuha shqiptare, edhe më tej do të ngelin si gjuhë dhe kulturë e popullit që është 20 për qind në numrin e përgjithshëm të popullsisë së Maqedonisë së Veriut! Për 3500 bullagër mund të shkatërrohet edhe shteti, kurse termi "shqiptar" assesi nuk guxon të bëhet kategori kushtutare! Ky është diskriminim demokratik, kurse në komunizëm shqiptarët, të paktën theksoheshin si pasuri e diversitetit shoqëror e kulturor!

*Bashkimi kulturor, mision i (pa)mundshëm*

# NË HAPËSIRËN SHQIPTARE "KOMUNIKOJNË" VETËM ANTIVLERAT

**Në hapësirën shqiptare ka njerëz të ditur, të zotë, të çmuar, por ka edhe kaos. Shoqëria jonë është e ngulfatur nga fataliteti i kaosit**

**Salajdin SALIHI**

Bashkimi kulturor mbarëshqiptar është i mundshëm dhe i domosdoshëm, por, siç duket, nuk është i dëshirueshëm nga vetë shqiptarët. Që të kemi integrim kulturor (jo në kuptimin folklorik) duhet më parë ta kuptojmë se kufijtë kulturorë shkojnë përtej kufijve administrativë. Mjerisht në hapësirën shqiptare "komunikojnë" vetëm antivlerat. Madje përkrahen nga institucionet publike, sepse spektaklet tërheqin audiencë e kjo u duhet prijësive tanë. Në hapësirën shqiptare ka njerëz të ditur, të zotë, të çmuar, por ka edhe kaos. Shoqëria jonë është e ngulfatur nga fataliteti i kaosit. Organizimi i kaosit në shoqëri, sipas Branko Merxhanit, është proces që duhet të

fillojë nga kultura. Ky proces do dije, mund dhe strategji afatgjate. Është proces evolutiv. Fjala "kulturë" nuk e duron fjalën "revolucion". Le të japim disa shembuj që ndërliohen me temën e mësipërme. Ernest Koliqi, kur ishte ministër arsimit, e krijoi një strategji afatgjate për ngritjen kulturore të shqiptarëve. Esad Mekuli ishte nismëtar i krijimit e institucioneve më të rëndësishme arsimore, kulturore dhe shkencore në Kosovë. Në këtë drejtim dha kontribut shumë të madh edhe "Rilindja" e Prishtinës, e cila, mjerisht, është vetëm pjesë e historisë. Në qytetin tim kishte dy librari të saj, ku shiteshin libra me çmim të lirë. Drejtuesit e "Rilindjes" kishin si synim që libri të depërtonte nëpër familjet shqiptare...

Sot mungojnë nismat cilësore kulturore. Flasi për integritet globale dhe na mungon integrimi kombëtar. Pasi nuk kemi strategji të përbashkët kulturore, rrjedhimisht as nuk e dimë si duhet të silllemi në rrethanat e reja, në kontekst të globalizimit dhe integritimeve evropiane. Mendojmë se Europës mund t'i afrohem vetëm duke miratuar ligje. Jo. Më parë duhet ta ngjallim ndjenjën e europianizimit brenda qenies sonë. Kjo arrihet nëpërmjet kulturës... Qytetërimi evropian vazhdon të ushqehet nga rrënjët e lashtësisë. Nuk duhet të harrojmë se BE është edhe projekt kulturor. Ajo u formësua nga njerëzit e kulturës. Viktor Hygo e paramendoj edhe monedhën e përbashkët evropiane. Kjo monedhë nuk duhej të kishte

simbole kombëtare, sepse mund të lindnin përçarje mes kombeve. Në "euro" tani kemi urën si simbol me të cilin identifikohen të gjithë evropianët. "Babai" i Bashkimit Evropian, Jean Monnet-i, tha se nëse do t'ia niste nga e para, atëherë do t'ia niste nga kultura... Tek ne kultura ka dalë në plan të fundit. Pascal Bruckner-i thotë: "Ditën kur budallai agresiv do ta udhëheq shoqërinë tonë, atëherë qenia kulturore do të trajtohet si idiot; do të trajtohet si ekzemplar i çuditshëm në zhdukje e sipër vetëm pse ende e respektonte thellësisht librin, disiplinën dhe mendimin". Jetojmë në kohën e spektaklit, kiçit, banalitetit. Fjalën kryesore e ka industria e argëtimit, që shumëfishon refrene, klishe, parulla...

Intervistë: Burhan Ahmetin, piktor dhe grafist

# PËRFITUAN ARTISTËT QË ISHIN AFËR PUSHTETIT

Shteti luan një rol kyç për afirmimin e artit dhe vlerave kulturore të një artisti vizual, mirëpo sa bën për të është pikëpyetje. Jo rastësisht viteve të fundit artistët shqiptarë në përgjithësi po lulëzojnë dhe shkëlqejnë nëpër botë, kurse në vendlindjet e tyre as që i njih dikush, përpos të afërmeve të tyre

Shkëlzen HALIMI

Burhan Ahmeti është grafist dhe piktor. Është lindur në vitin 1978 në Gostivar. Diplomoi në Fakultetin e Arteve të Bukura në Universitetin e Tetovës në drejtimin e grafikës, te klasa e Prof. Fatmir Krypa. Studimet master i kreu në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, kurse në vitin 2016 përfundoi ciklin e tretë të studimeve, ku e mbrojti disertacionin e doktoraturës në Universitetin Ndërkombëtar në Novi Pazar, te mentori Prof. Dr. Fehim Huskoviç. Ahmeti ka organizuar shumë ekspozita personale në vende të ndryshme të botës, si në Nju Jork, Paris, Berlin, Dizhon, Sofje, Cyrih, Prishtinë, Shkup etj. Ka marr pjesë në më shumë se 150 ekspozita ndërkombëtare, anuale, bienale dhe triennale të artit si dhe pjesëmarrës në mbi 80 koloni arti dhe simpoziume ndërkombëtare të artit në Kinë, Argjentinë, SHBA, Arktik, Angli, Kore të Jugut, Lituani, Belorusi, Rumania, Francë, Gjermani, Turqi, Egjipt, Spanjë, Itali, Zvicër, Bullgari, Greqi, Azerbejxhan etj. Ai njihet edhe si organizator dhe kurator i shumë ekspozitave, kolonive dhe simpoziumeve ndërkombëtare të arit në Maqedoni, Kosovë, Turqi dhe Egjipt. Veprimtaria e tij artistike është e shpërblyer me shumë çmime me karakter ndërkombëtar dhe lokal. Disa nga veprat e tij tanimë janë pjesë e koleksioneve të muzeve të ndryshme nëpër botë dhe e koleksionistëve privat.

**HEJZA: Ngjyra të tollovitura në pëlhurë, pak dritë, pak hije! Është ky stacioni i fundit i pikturimit modern?**

AHMETI: Artin modern duhet ta shohim në një kontekst të gjerë historik, shoqëror dhe filozofik, duke e hedhur poshtë dëshpërimin dhe nihilizmin që po e përshkojnë këtë epokë. Mendoj se si rezultat i kësaj është edhe reflektimi i tillë i artistëve modern, ku shihet sikur herë janë humbur e herë lulëzojnë në stacionin e fundit, duke u përsëritur me artin e tyre dhe si të vetmen rrugëdalje e shohin kthimin mbrapa. Sot, mënyra e të bërit art dhe përdorimi i ngjyrave, është e ndarë midis teorisë moderne dhe asaj "tradicionale", ku në mënyrë karakteristike theksojnë konceptet e hapësirës së ngjyrave, kuadrin e ngjyrës, vlerës dhe ngjyrës së sajuar.

**HEJZA: Çdo stil në art ka filozofinë dhe epokën e vet të emërtuar! Në ç'epoka mund ta kërkojmë artin e sotshëm konteporan! Çka po pikturohet sot në botë? Çfarë piktura po pëlqehen e çfarë po ekspozohen?**

AHMETI: Arti i sotëm krijohet nga artistë të ndikuar nga një jetë e larmishme si nga ana kulturore po ashtu dhe nga ajo teknologjike. Ky art është një kombinim dinamik i koncepteve, materialeve, metodave dhe subjekteve që vazhdojnë sfidën e kufijve që zhvillohej në shekullin e 20 -të. Ky art i larmishëm sot mendoj se ka mungesë të një parimi uniform, organizues dhe ideologjik. Arti bashkëkohor është një lloj fragmenti i dialogut kulturor që ka të bëjë me korniza më të mëdha kontekstuale si: identiteti personal dhe kulturor, kombi, familja apo komuniteti. Arti konteporan është vazhdimësi në një rrugë qorre, ku artistët bashkëkohorë kombinojnë gjithçka nga e reja dhe e vjetra, duke përdorur të kaluarën si një mënyrë për të kuptuar të tashmen. Pra, ato krijojnë një art që shikon drejt së ardhmes me elemente nga e kaluara. Më atraktivë janë ata krijues figurativë që përdorin ndonjë teknikë apo metodë specifike gjatë realizimit të një veprë arti. Kur një vepër arti mbartë në vete një emocion, nëse është e përkryer teknikisht



dhe estetikisht dhe nëse atë emocion e përçon te shikuesit (artdashësit), mund të themi se është pëlqyer te shumica. Rol të rëndësishëm në këtë aspekt luan edhe vetë autori i veprës, nëse në atë rreth ku jeton artisti, shumica e njohin krijimtarinë e tij, dhe nëse është komunikativ e i dashur me publikun, atëherë edhe kjo ndikon këtu te ne. Kryesisht si motive më të pëlqyera janë portreti, peizazhi, ato vepra arti me tematika religjioze apo abstrakte.

**HEJZA: A kemi shkollë autoktone të artit pamor, jo vetëm si disiplinë akademike! A kemi artistë të mëdhenj për të cilët duhet të investojë shoqëria jonë? Sa investojmë ne për të nxjerrë sot një Zef Kolombi, Kolë Idromeno, Guri Madhi, Ibrahim Kodra, Adem Kastrati, Omer Kaleshi, Ismet Jonuzi etj.**

AHMETI: Për dallim nga Shqipëria dhe Kosova, shqiptarët në Maqedoninë e Veriut nuk kanë një lice artistik në gjuhën shqipe. Është më se e nevojshme, pasi ka shumë të talentuar që regjistrohen krejtësisht në drejtime tjera si: në mjekësi, gjimnaz apo ekonomi dhe po të njëjtët përmes kurseve të artit i bëjnë përgatitjet për provimin pranues në ndonjë akademi arti. Pastaj në akademi të arteve ka rënie të cilësisë dhe pastaj vështirësinë më të madhe e kanë mësimdhënësit (profesorët) pasi gjatë vitit të parë duhet të merren me gjërat bazike, duke ua mësuar perspektivën, proporcionet apo vendosjen e një kompozicioni etj. Edhe një problem tjetër i rëndësishëm është arsimit bazë ku në kurrrikulat e artit figurativ që nga arsimit parashkollor, fillor dhe i mesëm, nuk ka një strategji dhe lidhshmëri të programeve mësimore. Shumë tema mësimore përsëriten gjatë disa viteve dhe bëhen monotone. Që nëpër shkolla fillore e të mesme, nxënësit të udhëhequr nga mësimdhënësit e lëndës së artit figurative, duhet të bëjnë sa më shumë vizita të ekspozitave nëpër muze apo galeri pasi që në atë mënyrë do iu ngritët vetëdija dhe interesimi i nxënësve për artin, kulturën dhe trashëgiminë tonë kulturore. Ata pastaj më me lehtësi do mësojnë të identifikojnë vlera estetike dhe njerëzore në një vepër arti, duke e kuptuar ndikimin e artit në këtë shoqëri dhe do kenë një bazë të shëndoshë duke i zhvilluar aftësitë e tyre artistike përmes gjykimit estetik, mendimit kritik, dhe përmes krijimeve artistike konkrete. Shqiptarët në përgjithësi janë të talentuar për art, mirëpo sa bëjmë ne dhe sa investojmë sot për të nxjerrë në dritë artistë të rinj, të cilët do lenë gjurmë në histori. Çdo shkollë duhet të ketë kabinetin e artit figurative të dizajnuar me shije, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe artistike për krijim. Një kënd biblioteke me libra arti si dhe për çdo drejtim të artit mjete pune. Gjithashtu duhet të stimulohen të rinjtë e talentuar, duke i njohur me veprimtarinë artistike të artistëve shqiptarë më të njohur e më të suksesshëm, të vizitohen studiot e tyre, t'u jepet mundësia që të komunikojnë me piktorë, skulptorë, grafistë, arkitektë, disenjatorë. Pra, në këtë mënyrë e kemi kryer një punë të rëndësishme, një investim të sigurt për shoqërinë tonë, për të rinjtë të talentuar, studentët e artit apo artistët e sapodiplomuar.

**HEJZA: Ekspozitat sezonale të punimeve artistike a do të ndikojnë në krijimin e një tradite për blerjen e këtyre veprave nga shkollat tona, nga dikasteret qeveritare, nga ndërmarrjet tona, nga kazemat, nga institucionet nacionale, nga individë-koleksionistë të ndryshëm!**

AHMETI: Te shqiptarët e Maqedonisë së Veriut tradita e blerjes së veprave të artit ka filluar disi më vonë krahas Shqipërisë apo Kosovës. Para viteve të 90-ta deri në vitin 2000 ishin shumë pak artistë aktiv me veprimtarinë e tyre artistike dhe që çelnin ekspozita. Me hapjen Akademisë së Arteve në Universitetin e Tetovës në vitin 1994, filloi një epokë e re këtu. Në atë periudhë shumica e popullatës shqiptare në Maqedoni nuk kishte njohuri për shumë drejtime apo teknika të artit. Pra, falë kësaj akademie, dhe falë kontributit të shumë profesorëve nga Kosova, filluan të diplomojnë gjeneratat e para në drejtime të ndryshme të artit si në pikturë, skulpturë, grafikë dhe dizajn grafik. Filloi që të ndryshon dhe mentaliteti, në



muret e shtëpive filluan të vendosen vepra arti, të organizohen ekspozita grupore dhe individuale si dhe filloi dhe një traditë e re e shit-blerjes së veprave të artit. Deri vonë në Maqedoni nuk ishte i qartë qëllimi i një ekspozite personale apo grupore, shumica e artdashësve pyesnin me skepticizëm se a shiteshin ato vepra arti të ekspozuara, duke u habitur kur përgjigjja ishte "po", kuptohet. Interesimi për blerje të veprave të artit dita ditës shkonte në rritje, bliheshin vepra arti qoftë nga biznesmenë, politikanë apo funksionarë të ndryshëm. Me avancimin e pozitës shqiptare në pushtet, filluan edhe blerjet e pikturave, grafikave, fotografive artistike nëpër institucione të ndryshme të udhëhequra nga shqiptarë. Mirëpo jo çdo artistë përfitoi nga këto mundësi, pasi dihet se çdoherë cili artistë ka qenë më afër pushtetit apo politikës, ai ka përfituruar. Edhe pse shumë artistëve tjerë nuk iu dha kjo mundësi. Gjithashtu kishte një periudhë kur muzetë e vendit blinin vepra arti, mirëpo edhe në rastet e tilla përfituan vetëm ata artistë që kishin lidhje me pushtetin. Mirëpo, përpos këtyre mundësive të lartpërmendura, krijuesit figurativë që ishin më aktivë në jetën kulturore kishin edhe alternativa tjera

për shitje, sepse u shtua edhe numri i biznesmenëve, artdashësve tjerë, intelektualëve dhe koleksionistëve. Viteve të fundit kriza ekonomike globale e bëri të veten, pandemia gjithashtu i mbylli edhe ato pak dyer të hapura që i kishin artistët, stagnoi ai ritëm i mirë i sapo filluar, duke mbetur me shpresë se në një të ardhme të afërt do ringjallet gjithçka.

**HEJZA: Pse një piktor produktiv shqiptar që jeton jashtë atdheut mund të jetë me famë botërore, kurse në vendin e origjinës së vet mund të njihet nga tre-katër persona të të njëjtës fushë! I ka fajet "atdheu" apo piktura!**

AHMETI: Artistët shqiptarë me famë botërore janë kryesisht ata artistë që u edukuan në vendlindje, u rritën dhe u zhvilluan pastaj emigruan nëpër botë, duke krijuar një art me emocione të thella të vuajtjeve të ndryshme ndër vite dhe duke e gërshtuar atë me përvojën e shkollave tjera që u njohën atje. Për fat të keq, talentet e rinj këtu te ne nuk trajtohen mirë, nuk iu jepet rëndësi e duhur dhe nuk përkrahen sa duhet. Andaj detyrohen si rrugëdalje t'ua



mësyjnë kryeqendrave botërore, pasi atje më lehtë mund të depërtohet me artin e tyre, t'ju vlerësohet më drejtë dhe mundësitë për të shitur apo për ta promovuar artin e tyre janë shumë më të mëdha. Falë internetit, shumë artistë të rinj e të talentuar që janë kreativ dhe inovativ me artin e tyre, edhe nëse nuk kanë shumë mundësi financiare, ata mund të depërtojnë me shumë lehtësi vetëm nëse pak dinë se si ta menaxhojnë dhe promovojnë artin e tyre nëpër botë.

Shteti luan një rol kyç për afirmimin e artit dhe vlerave kulturore të një artisti vizual, mirëpo sa bën për të është pikëpyetje. Jo rastësisht viteve të fundit artistët shqiptarë në përgjithësi po lulëzojnë dhe shkëlqejnë nëpër botë, kurse në vendlindjet e tyre as që i njih dikush, përpos të afërmeve të tyre. Pra, kushtet, mundësitë, infrastruktura dhe politikat kulturore të shteteve perëndimore janë faktorë të rëndësishëm për ato suksese. Nga përvoja ime, çdoherë kur kam dalë jashtë shtetit me ekspozita personale apo grupore, jam ndier i plotësuar si artist, sepse jam vlerësuar me shumë sinqeritet, nuk ta bënte qejfin asnjëri atje, por ta thoshin të vërtetën sa i përket krijimtarisë artistike. Vendi ynë është një fidanishte intelektualësh dhe talentesh arti që fatkeqësisht nuk trajtohen mirë për shkak të anomalive të shumta politike në vend. Kështu, ato talente detyrohen që të sakrifikojnë shumë në mërgim dhe të japin frutat larg atdheut. Për këtë komunitet artistësh duhet të këtë një qasje më serioze, më njerëzore, më konkrete, më të sinqertë nga pushteti dhe jo thjeshtë vetëm fjalë.

**HEJZA: Po të ishit pushtet, cili do të ishte raporti i juaj ndaj kulturës e në veçanti, ndaj artit figurativ! Shqiptarët tashmë kanë provuar të drejtohen edhe prej persona nga sfera e artit figurativ por edhe nga letërsia. Çka i dhanë nga kultura pushtetit e çka nga pushteti kulturës?**

AHMETI: Për komunitetin e artistëve është shumë e rëndësishme që udhëheqësit e një pushteti të jenë përkrahës dhe bashkëpunues me ta. Një pushtetar kurrë nuk duhet të jetë si bartës kryesor i aktiviteteve kulturore dhe artistike të një vendi, por me rëndësi është që ai duhet ta rregullojë sistemit kulturor dhe politikat kulturore të një vendi. Ndërsa si prijës kryesor të aktiviteteve nga sfera e artit figurative, muzika, teatri e letërsia, duhet të jenë vetë krijuesit figurativë, institucionet, organizatat kulturore dhe të gjithë ata persona që kanë një vizion kreativ.

Nëse nëpër ato dikastere angazhohen persona adekuat që e kanë dëshmuar profesionalizmin e tyre në profesione, atëherë padyshim se do të ketë sukses. Në rastet kur institucionet e kulturës drejtohen nga profesionistë rezultatet janë më konkrete, mirëpo pati raste kur po të njëjtat institucione ndikoheshin më shumë nga politika, atëherë rezultatet ishin më të zbehta bashkë me pritshmëritë nga ana e artistëve. Duke i afuar pushtetarët që të jenë pjesëmarrës aktiv nëpër eventime kulturore, ekspozita, ata do e kuptojnë rëndësinë, peshën dhe kostot reale të këtyre aktiviteteve dhe do jenë më shumë përkrahës herëve tjera. Mendoj se qeveritarët duhet ta rishqyrtojnë modelin aktual të financimit të institucioneve nacionale, artistëve dhe të projekteve të interesit nacional, duke e avancuar ndarjen e buxhetit për kulturë. Një sistem i ri i financimit do duhet të tejkalojë programin vjetor. Duhet të krijohen fonde të veçanta për drejtimet e ndryshme në sferën e kulturës, të cilat do të kenë autonomi dhe mandat të përkufizuar dhe më afatgjatë, duke pasur përgjegjësi të plotë për selektimin e projekteve nga fusha e artit pamor. Kultura dhe arti çdo here e japin dyfishin e asaj që ua jep pushteti. Një fjalë e urtë popullore thotë: "Sa para, aq muzikë". Te ne pushteti artit dhe kulturës i jep shumë pak para, por artistët ua kthejnë me shumë art. Paramendoni sikur të përkraheshim mjaftueshëm, aktivitetet kulturore sa profesionale do bëheshin, improvizime nuk do të kishte, vetëm cilësia dhe profesionalizmi do vinin në shprehje. Mbetemi me shpresë se kjo ëndërr e kamotshme e çdo artisti, një ditë do të bëhet realitet edhe këtu te ne.

# JETA E SAMI FRASHËRIT E TREGUAR NGA E BIJA


(Copëza nga jeta e Sami Frashërit, të treguara nga vajza e tij, e të përmbledhura në librin e gazetarit turk, Hikmet Feridun Es, "Njerëzit e famshëm që nuk i njohim")

Në librin "Njerëzit e famshëm që nuk i njohim", me autor gazetarin turk Hikmet Feridun Es, mes personaliteteve spikat edhe enciklopedisti, dramaturgu, gjuhëtari, romancieri, përkthyesi, njeriu i rrallë për të gjitha kohërat, Sami Frashëri - apo Shemseddin Samiu, siç njihet në historiografinë turke. Mes tyre, ai ka përcjellë për lexuesin kujtimet shumë të veçanta, treguar me shumë dashuri dhe besnikëri, nga vajza e madhe e Sami Frashërit, Samija. Gazetari thekson, se e bija ia kishte rrëfyer kujtimet për të atin, kur ishte 60-vjeçe, por ruante kujtesën e një 20-vjeçareje. Mes të tjerash, ai thekson se Sami Frashëri kishte shumë shokë të ditur të kulturës islame, por nga pikëpamja e besimit fetar ai ishte ndarë nga ata përfundimisht, edhe pse fjala e fundit që ai ka thënë kur ndërroi jetë ishte fjala "Allah"(Perëndi). Në shkrimet e tij, gazetari Hikmet Feridun Es, sjell nga kujtimet e Samijes: "Sami Frashërin nuk e ka shqetësuar asnjëri. Nëse hapni ngadalë derën e dhomës në katin e dytë, në fillim nuk keni për të mundur të shihni asgjë, vetëm grumbuj-grumbuj librash. Hidhni sytë dhe do t'iu dalë një koke madhështore, tërheqëse, me një mjekër të gjatë dhe krejt të bardhë... Nën dritën e qiririt ai krijoi botën e shkencës...

Deri sa të kishte lindur dielli, ai shkruante shkrimet e tij, i redaktonte ato dhe pasi i dërgonte në shtypshkronjë, shtrihej përsëri". "Samiu ulej në një minder, i cili kishte madhësinë që mund të ulej vetëm një person, duke të kujtuar një divan të vogël. Kolltuku i tij i punës kishte disa gjëra specifike. Ai ishte i harkuar dhe ishte i mbuluar me një copë ngjyrë vishnje. Ulej mbi kolltuk dhe shpinën, kurrizin nuk e mbështeste në asnjë vend. Punonte vazhdimisht në një pozicion të përkulur. Letrën e kthente nga njëra anë dhe e mbështeste mbi gjunjë. Ai, gjithashtu, në të njëjtën kohë u drejtohej librave. Për këtë kishte bërë një tavolinë me një plan të vetin, në një mënyrë të veçantë. Kjo është një tavolinë mjaft e gjatë, sirtarët e së cilës zgjateshin kur hapeshin me tërheqje të ndryshme. Mbi të qëndronin hapur libra në gjuhë të veçanta, ndonjëherë në 6-7 gjuhë të ndryshme, të cilat do t'iu duhej t'i shikonte dhe t'iu drejtohej. Kjo tavolinë gjendet tek vajza e madhe që e ruan atë ashtu siç ka qenë. Zonja Samije Erer, e cila ndodhet përballë tavolinës, thotë: 'Për librat që ai do të lexonte, kjo tavolinë nuk ishte e mjaftueshme'. "Në mes të grumbujve të librave, të cilët lartësoheshin në çdo cep të dhomës, ai vetes së tij i kishte caktuar një vend, një folë. Në këtë ambient, duke kaluar përmes cepave të këtyre grumbujve librash qëndronte duke punuar trupi i tij mjaft i lehtë. Në kohën që ju hyni në dhomë, ju nuk mund të shikoni atë nga poshtë qafës. Dhe, akoma më tepër, në hapin e parë ju do të ndjeni

një aromë të veçantë. Kjo aromë do të ishte 'era e librit', e cila do të godiste menjëherë hundën tuaj. Zonja Samije Erer, me sytë e saj të kredhur në mendime dhe të vërejtur, duke parë tavolinën në të cilën Samiu ka kaluar përballë saj gjithë jetën e tij, shton: "Tani, me të hapur një libër të vjetër, me të ndërë aromën e një libri, është njësoj sikur unë ndjej erën e babait tim". "Ne të dy anët e tavolinës, ndodheshin dy mbështetëse. Dhe në këto qëndronin letrat e dijetarit, dorëshkrimet, boja, pena. Drita vazhdimisht vinte nga mbrapa. Për këtë ai kishte bërë raftë të posaçëm për të vendosur qiririn. Në raftin i cili ndodhej mbrapa, qëndronte një shandan trekëndor. Kurse në mbështetëset, në secilën prej tyre, ishte vendosur një qiri. Dijetari, sipas nevojës, i tërhiqte nga atje-këtu, djathtas-majtas. Sipas nevojës, shkonte në tavolinë për të hapur librat voluminozë me trashësi të madhe. Vendosjen e qirinjve e kishte bërë në atë mënyrë që të kryqëzoheshin në të njëjtën kohë me syrin e tij".

"Vazhdimisht shkruante në letër me madhësi të gjatë dhe ngjyre të kaltër të errët, jo të hapur. Pjesët anësore të letrës gjithmonë i përthente dhe i linte bosh për të bërë korrigjimet dhe shtesat e tjera të mëvonshme. Rregullisht në shkrimet e tij përdorte vetëm bojën e zezë. Mirëpo, në veprat me tre tekste, për të mos i ngatërruar ato me njëri-tjetrin, përdorte tre lloj ngjyrash - të kuqe, të kaltër dhe të gjelbër. Mirëpo, ngjyrën e kaltër nuk e ndryshoi. Penën e tij do ta përgatiste me kujdes të veçantë, përpara se të fillonte të shkruante. E përthente, i jepte asaj një formë të hollë dhe të trashë. Ndiente kënaqësi nga përthyerja e penës. Shishja e bojës përbehej nga qelqi dhe ishte në atë formë që po të përmbysesj, boja nuk derdhej dhe ishte nga lloji më i lirë". "Në kohën që punonte, nuk do të futej asnjëri në dhomën e tij. Mirëpo, me të mbaruar punën, ai bënte diçka të veçantë. Kur mbaronte korrigjimet, përplaste tri herë duart me njëra-tjetrën. Kjo përplasje e duarve ishte e vetmja shenjë që thërriste vajzën e madhe, Samijen Ererin. Ajo ndodhej në dhomën ngjitur me atë të Samiut. Me të dëgjuar zhurmën e duarve, vajza e re fluturonte nga krevati dhe do të vraponte pranë babait të saj. Në këtë kohë do të ishin orët më të mira të babait me vajzën, e cila kishte ngelur pa nënë që në moshën gjashtëvjeçare". "Samiu kishte një zakon në orët e mëngjesit të përgatiste një ponç me konjak, limon dhe çaj. Çajin e ziente me dorën e tij. 'Babai e pinte këtë çaj, filxhan mbas filxhani'. Samiu tregonte mjaft tregime të bukura. Pastaj, vajza e re Samije, duke thënë 'Babaxhem, Perëndia të dhëntë qetësi', do të dilte nga dhoma, sepse dijetari i madh mbasi dërgonte dorëshkrimet në shtypshkronjë, shtrihej për të fjetur".



Artisti për artistin

# LASGUSH PORADECI, NJERIU MË I JASHTËZAKONSHËM

Gjatë udhëtimeve në shumë vende të botës më ka qëlluar rasti të njihem me njerëz të pazakonshëm, nobelistë, filozofë, aktorë, politikanë, shkrimtar të mëdhenj, por gjer më sot Lasgush Poradeci ka mbetur për mua njeriu më i jashtëzakonshëm



## Ismail KADARE

Ajo çka, në vend që të më mundonte, më mahniste gjithmonë, sa herë që takoja Lasgush Poradecin, ishte ndjesia e së pamundurës. Ishte e pamundur të merreshe vesh me të si me të tjerët. Porsa hyje tek ai, madje porsa trokisje në portë, aty për aty gjithçka tjetërsohej. Tjetër logjikë në të biseduar, tjetër kod, të tjera fjalë, të mbështjella me kuptim tjetër. Diçka mungonte përherë, e diçka që e tepërt. Ai vetë ishte aty, i vëmendshëm për gjithçka, e megjithatë, ti e ndjeje se sa ç'ishte, aq edhe mungonte.

Më e habitshme ishte se ty të pëlqente kjo, se nuk doje aspak që të prishej kjo magji, ashtu si nuk doje që fjalëve që thuheshin t'u ikte dysia, velloja me të cilën sapo ishte mbështjellë dhe t'u ktheheshin kuptimet e tyre të mirëfillta, që ngjanin tani të zbehta. Një njeriu meskin do t'i dukej i krisur, një tjetër mund të mendonte se atë mjegullirë ia krijonte pleqëria. Por s'ishte as e para, as e dyta.

Lasgushi ishte aty, disa qindra hapa larg, megjithatë, përse nuk nisesh me ngut, me panik, për të mos humbur kohë? Përse nuk kam shkuar më shpesh, thosha me vete. Dhe prapë shkoja rrallë. S'kisha kurrfarë droje se do ta shqetësoj. Ai më priste përherë me kënaqësi, madje më çonte fjalë t'i shkoja.

Ishte një pengesë e tjetërfartë. Pengesa që shkakton ëndrra. Askush nuk ngutet të shkojë drejt saj. Sepse, në fund të fundit, vonesa dhe ngadalësia bëjnë pjesë në mekanikën e saj.

Të shkoje tek ai, ishte më shumë se të dilje jashtë shtetit. Të dukej se dilje jashtë kohës, jashtë sistemit të zakonshëm të të menduarit. Edhe një hap dhe kishe ndjesinë se do të kapërceje kufijtë e jetës për të shkelur në shkretinë danteske.

Prej vitesh, qysh pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, ai kishte qenë përherë i tillë: i gjallë dhe i vdekur njëkohësisht. Shumë gjimnazistë, që e bënë në mësim, e kujtonin të vdekur. Të tjerë ua shpjegonin se nuk ishte ashtu, se ishte gjallë, por as të parët, as të dytët nuk habiteshin nga kjo. Ishte një gjendje e dyzuar që i shkonte atij dhe shumë njerëz qenë mësuar me të, si me dikë që e kundrojnë përherë nën syprinën e ujit. Ishte nga të rrallët njerëz dhe, ndoshta, i vetmi shkrimtar i madh që arriti për një kohë aq të gjatë, duke qenë i gjallë, të përjetojë vdekjen e tij.

Pamja e tij e jepte shpeshherë në mënyrë të saktë këtë dyzim, sidomos kur vishte kostumin e zi dhe vinte borsalinë të zezë. Në një rast të tillë të dukej e natyrshme ta pyesje nëse dilte apo shkonte drejt arkivolit. Më e çuditshme ishte se ky fat i tij nuk

zgjonte keqardhje. Ndjenja e keqardhjes, e mëshirës së mundshme, e pikëllimit që ai që harruar pa të drejtë, thërrmohej si një enë kristali sapo ndeshje me të.

Kur ai hynte në kafenetë e Pogradecit, shkrimtarët që vinin për verim kishin ndjesinë se po strukeshin nga një stuhi e padukshme. Ai ishte i paparashikueshëm, gërryes si acid, i rrezikshëm, i beftë. E qeshura e tij ishte si e tejetshme, pa gëzim, mërziqia e tij e papikëllueshme. Kështu e kishte edhe zemërimin, luksoz, të ftohtë, kurse përbuzjen, rrezatuese që larg, si të stolisur me argjend.

Por gjëja më e jashtëzakonshme ishte e folura e tij. Gjë më të pangjashme me bisedën e përditshme, nuk mund të përfytyroje dot. Ndonëse ishte e qartë, pa stërholim, fare e rrokshme, madje për gjëra të ditës, ajo e kishte kryekëput të ndryshme gjithçka: ndërtimin e saj, logjikën, ritmin, kthimet prapa. Ishte e papërfutueshme, të mendoje që ai ose ti, në fillim të bisedës, të thoshit diçka për kohën, shëndetin, ose shprehjen ç'të reja kemi? Ai mund të shikonte ftohtë, të mos përgjigjej dhe të harronte që ti ishte aty. Çdo takim me të ishte përherë befasues, jashtë çdo skeme dhe parashikimi...

...Mekanizmi i kohës së tij ecte herë përpara, herë mbrapsht e herë në vend. Edhe oraret

ashtu i kishte: çohëj nga gjumi në orën 11. Hante mëngjes. Flinte përsëri në 12. Hante drekën në 5 mbasdite. Flinte në 6. Çohëj në 8 dhe punonte gjer më 3 pas mesnate. Pamja e tij, po aq sa e folura, i shpëtonte çdo cilësimi. Ai ishte aristokrati dhe fshatari njëkohësisht, vjenezi i përkorë dhe ballkanasi me shkop shtogu, bjondi dhe bruni, i ashpri dhe fini. Ai herë të kujtonte aktorin gjermano-shqiptar të viteve '30, Aleksandër Moisiun, herë grekët e lashtë të mbështjellë me zhgun jashtëkohor, e herë Papa Gjon Pali II. Gjatë udhëtimeve në shumë vende të botës më ka qëlluar rasti të njihem me njerëz të pazakonshëm, nobelistë, filozofë, aktorë, politikanë, shkrimtar të mëdhenj, por gjer më sot Lasgush Poradeci ka mbetur për mua njeriu më i jashtëzakonshëm, më i ndërlikuar e më i pakuptueshëm që kam njohur. Kam biseduar për të me njerëz që i kishte edhe më të afër: të shoqen, vajzat, gruan që ka qenë pasioni i tij i fundit, por askush nuk ka kuptuar diçka më shumë prej tij. Me sa duket, kodin zbrëthyes ai e mori me vete në varr. Duke e parë, dhe sidomos duke e dëgjuar, gjithmonë mendoja se si ishte e mundur që njeriu ballkanas, njeriu shqiptar, të arrinte një ndërlikim të tillë, përkryerje, mëvetësi dhe mister.

(Shkëputur nga libri "Ftesë në studio")

# NË TAKIM ME ARSHI PIPËN

Profesor Arshi Pipa telefonoi se na priste në shtëpinë e tij atë paradite në Ëashington, ora 10.00. Meqenëse kishim dhe ca kohë, vendosëm të futeshim në librarinë pranë dhe pastaj të vazhdonim një shëtitje të shkurtër.

Nga Visar ZHITI

Profesor Arshi Pipa telefonoi se na priste në shtëpinë e tij atë paradite në Washington, ora 10.00. Meqenëse kishim dhe ca kohë, vendosëm të futeshim në librarinë pranë dhe pastaj të vazhdonim një shëtitje të shkurtër. Uashingtoni, po mendoja, është qytet me fizionomi klasike europiane: s'ka qiellgërvishtës, siç është përfytyrimi i shqiptarëve të padalë për Amerikën, por sheh blerime kudo, rrugë të pastra e qetësi të bardhë. Mbase këtë ndjesi ta japin Shtëpia e Bardhë, Kapitoli, Bibliotekat e famshme të Kongresit, të gjitha të bardha. Një kryeqytet që ka shumë e shumë më tepër pemë, se... policë. Se na kishin thënë ndryshe.

Dhe sa shumë ketra! Ketra qytetarë!... Ndalin, na shikonin në sy, s'kishin frikë nga njerëzit, madje prisnin t'u jepje diçka për të ngrënë, biskota, shiteshin enkas dyqaneve, afroheshin, tundnin bishtin e madh e të bukur si të argjendëtë, dilnin dhe në rrugë, vraponin poshtë veturave të ndalura, endeshin, ktheheshin pas, u ngjiteshin me vrull pemëve, një zot e di se ç'kërkonin. Edhe ne tani po nxitonim. S'donim të bëheshim vonë për në shtëpinë e profesor Arshi Pipës, nën një diell që po më dukej i bardhë dhe ai. Mbas trokitjeve tona të buta, portën na e hapi motra e moshuar e profesorit, ndërsa në krye të shkallëve të drunjta lart, në katin e dytë, na priste vetë profesori, në këmbë, i drejtë, i gjatë dhe i hollë, me flokët e bardha, "të uashingtonta", por dhe si borë e largët e atdheut, që nuk shkrin kurrë. Vetullat çuditërisht të zeza, siç dukej një shenjë e përzishme nuk shkëputej për jetë nga fytyra fisnikërisht gjatoshë e tij. S'dita ta përcaktoj në e theksonin apo e neutralizonin pamjen disi skeptike të asaj fytyre a i jepnin rini më shumë, bashkë me një pesimizëm të mençur, por gjithsesi me një përzemërsi të palodhur.


- E di emrin tënd, - më tha, kur u ulëm në kolltukët e thjeshtë, - je poet i ri dhe ke qenë në burg. Kësaj të dytës unë i jap rëndësi.

Menjëherë i tregova ç'dija për "Librin e burgut" të tij, ç'kisha dëgjuar dhe si e kisha lexuar më në fund. Kur autori që arratisur, pikërisht ato sonete skëterore kishin bërë rrugë të kundërt me autorin, po aq të rrezikshme, në mos më shumë, qenë futur fshehurazi në atdhe, përmes telave me gjemba. Kisha bërë përpjekje për të botuar një cikël prej tyre në shtypin e ri opozitar tonin. Kujtova sonetin për një të shtrirë në vig, që vdekja e shndërroi në arkivol lecke...

- Më ka ndodhur... me tim atë, - shpjegoi profesori, - vdiq udhës në burg. Edhe zëri i tij sikur zbardhte, i njëllotë, me pak ngjirje që ai ia vinte fajin torturave, - prandaj më del i tillë. Me ftohje. Çimento qelish. Në fisin tonë, - po tregonte profesori - s'kemi kënd me zë të tillë. Pastaj ne e çuam në spital, - qesh me ironi, por zëri iu prish. Kë kishin çuar në spital, babain e vdekur apo zërin?

- Ne e njohim këtë zë, - ndërhyra, - që s'e prishi dot diktatura. Dhe tregova librat e tij mbi tryezë, tek të cilët po hidhte autografe, po m'i dhuronte mua.

Ime shoqë shkrepri befaz aparatit fotografik mbi ne. Me siguri do t'i jetë fanitur gjyshi i saj, të cilin dhe atë e burgosën në kënetën e Maliqit, ja, atje ku ishte dhe profesori, me siguri do të



jenë njohur... mbi baltë, ku shpesh policia të rrëzuarit, ata që binin nga mundimi i madh dhe uria e madhe, i shkelte me këmbë. Hipnin me çizme mbi shpinën e njeriut të dënuar deri sa e zhynin thellë e më thellë, në llumin e pafund, në kënetën e vdekjes. Po gjyshi i saj mbeti gjallë, edhe atëherë kur i hodhën një bombë policët e një njeri tjetër kërcë, se e dinte copë buke e donte ta priste, por u bë copë-copë.

Dhe prapë do ta arrestonin Dane Zdravën, gjithmonë, sepse kishte qenë biznesmeni i parë, ai kishte sjellë kinemanë e parë në qytetin e tij, në Berat, po ja, që ishte dhe me akademi në Itali, sillte centrale elektrike, autokombajna në tokat e tij dhe falte peliçe apo bënte pajën e të gjitha vajzave të miqve të tij dhe teksa e nxirrnin nga shtëpia të lidhur me pranga, përqafor për herë fundit mbesën e vogël, të sapokthyer nga shkolla... e ajo tani fotografon bashkëvuajtësin e gjyshit, të cilit as varri nuk i dihet ku është. Me siguri do të jenë njohur bashkë, kanë folur, edhe pa e ditur se kush janë, atje, në kënetën e vdekjes, kanë shpresuar.

Autori i soneteve të baltës së burgut pati fat pastaj, e kërkoi fatin, e bëri vetë dhe ja tani bisedon me atë që është i shoqi i saj, edhe ai me plot poezi burgu gjithë errësirë ferri.

- Jam familje borgjeze, - vazhdonte të rrëfente profesor Pipa, - jo në kuptimin që e përdorin komunistët. Në familjen time janë marrë me gjyqësi të gjithë: gjykatësa e avokatë ishin e mua m'u desh të bëja punë proletari, më të rëndë se proletarët. Po burgut i jap rëndësi, e quaj universitet...

- ... të zi, - shtova unë. Pastaj Profesori nisi të flasë për Fransua Vinjonin, poetin rebel, vagabondin, të burgosurin, të dënuarin me varje, por që i shpëtoi litarit... (Ah, Avzi Nela yni, nuk i shpëtoi dot... diktatura komuniste ishte më keq se mesjeta.) E dua Vijonin, - m'u duk sikur u rrëmbye profesori, por gjithsesi i qetë, me qetësinë e mistershme që gjen në një tempull. Me Vijonin shihet se jeta është tjetër gjë dhe tjetër poezia. Edhe krijimtaria e Kadaresë është kështu... Madje edhe "Dasma" është roman disident...tha dhe heshti gjatë. S'doja t'i ndërhyja. Vetëm

doja ta dëgjoja.

Ashtu siç thuhej, Arshi Pipa shihej që ishte njeri i prerë, i pakompromis, "madhërisht i pamëshirshëm" me diktaturën, të cilën ai e sfidoi, jo vetëm si mërgimtar politik, por si poet dhe si mendimtar, mbi të gjitha. Profesori do të pohonte pa mëdyshje që Atdheu ynë është më mirë se dikur, tani që në pushtet janë demokratët, megjithë rezervat që mund të kihen. Diktatura e bunkertë u çua nga brishtësia e demokracisë. Në fund të fundit demokracia është edhe kritikë për të përmirësuar veten.

Dhe deshi të më tregojë përkthimet e tij nga klasikët e mëdhenj, Dante e Petrarca, Gëte... francezë, rusë e rumunë.

- I kam përkthyer, - po thoshte profesor Pipa - ca me toskërisht e ca me gegërisht. Po t'i jap, por mos i boto. I përgëzoj botimet kosovare që arritën të shkruhen në gjuhën letrare, megjithëse ata ishin për përdorimin e dy dialekteve, edhe unë. Janë pasuri, - këmbënguli.

- Edhe gjuha e përbashkët letrare është! - iu përgjigja.

- Erdhi shpejt - tha sërish.

Ndërsa pinim kafetë, unë u ngrita të shoh raftet e çuditshëm të librave. Të gjatë dhe bosh! Bo-o(h)-osh... Vetëm ca fjalorë, dorëshkrimet e fundit në një qoshe, ksomblat e librave të tjerë, vepra të mikut të tij të madh Martin Camaj. Kaq! Dhe dhembje e drunjte. Ç'kishte vdekur aty? Ja, ca fotokopje të zmadhuara të letrave të cigareve, ku kishte shkruar dikur poezitë e burgut. Me ato ishte arratisur...

Se si dukeshin ashtu raftet, dramatikisht bosh si arkivole. Sërë-sërë. Ku janë librat, desha të bërtas së brendshmi. Të gjithë bibliotekën, librat e të gjithë jetës, ia kishte dhuruar bibliotekës së qytetit të Shkodrës. Një gjest i lartë ky, që e bëri vetë, qysh në gjallje, pa ia lënë si detyrë testamentit. Pse? Mendoja rrugës së kthimit. Ku e gjeti fuqinë të ndahet me librat e veta, qëllimin e jetës së tij?

- Po merrem me filozofi tani, - më tha, kur e pyeta se ç'po shkruante.

Pra, ai po guxonte të jetonte me humbjen e pashmangshme, me vdekjen e vet, pa sfond librash. Mos është dëshira

filozofike e të jetuarit me të, që njëherësh është dhe triumf mbi vdekjen?

Dhe pikërisht kur unë i tronditur kundroja atë boshësi të drunjte, bibliotekën e padukshme, të mërguarën, dëgjoja zërin e tij që kritikonte një seminar ortodoks në Amerikë të lobit grek. Pastaj folëm për eposin ballkanik. Ka një trill dhe turp, tha ai, për të vjedhur histori të të tjerëve. Zhvatim tokat dhe legjendat dhe trazojmë të vdekurit. Politizojmë miqësitë, por dhe sëmundjet, kurse eposin e kemi njëmbëdhjetë rroksh. Që e kanë sillavët e jugut. Atëherë ç'mund të themi?

Shkrimtari jugosllav Ivo Andriç, gjeta rast dhe po i thosha, thotë se Kënga e Gjergj Elez Alisë është shqiptare. Po, shqiptare është, pohoi me një kërshe si të ftohtë Arshi Pipa. Ku do të dilja? Po a është njëmbëdhjetë rroksh "Gjergj Elez Alia", gati bërtita miqësisht. Po, tha përsëri dhe heshti. Në sy po vdisnin raftet librash, por jo kujtesa e tyre.

Po shikoja dedikimet në veprat që më dhuroi: "... poetit të ri dhe shokut të burgut...", "... këtë libër të shkruar dhe plotësuar në mërgim", "për kujtim të takimit në Uashington, më 23 gusht 1994, përzemërsisht..." dhe kishte firmosur poshtë emrit të shtypur në frontespis: "Arshi Pipa", me shkronja të vogla.

Seç m'u bë brenda në kraharor një si brengë dhe boshësi si ajo e rafteve. Desha të kujtoja patjetër ketrat dhe zgjata dorën në ajër, sikur po i ndillja. Arshi Pipën do ta takoja dhe një herë tjetër në Tiranë, mbajti një leksion të shkëlqyer për poezinë e Martin Camajt, që s'jetonte më. Me poezinë e tij fillon paqja në poezinë shqipe, tha profesori. Më vonë erdhi lajmi i zi nga Amerika se Arshi Pipa kishte vdekur dhe kishte kërkuar që hiri i tij të shpërndahej... mbi atdhe.

(Ky takim është përshkruar në librin me ese të Zhitit, "Në emër të a(r)tit", botuar në Shkup më 2006)



Në veten e parë

# SHKRIMTARI NDËRTON LIRINË E VET NË VEPRËN E TIJ


Për Shkrimtarin sot, edhe Metafora e djallit mund t'i shërbejë për ta krijuar Veprën e Djallit që i rri kundruall dhe ia zë hisen e tij të Diellit

Beqir MUSLIU

Metafora e Jetës sime është Ëndrra për Lirinë. Këtë orvatem ta bëjë sa më të lirshme, sa më të lehtë, meqë Ëndrra edhe si Metaforë është më afër realitetit tim jetësor, edhe krijues. Por shumë gjëra i mbesin ditës tjetër për t'u realizuar, jo vetëm si Metaforë, por edhe si sendërtim të një ideali jetësor, kombëtar, por edhe artistik. Siç thotë në një varg miku im dhe poeti i mirënjohur Teki Dervishi: "Dhembja na u bë punë që lihet për nesër", andaj, edhe metaforat sikur i palojmë thellë në dhembjen tonë (timen) për t'i shpalosur Nesër, meqë ajo Nesër mund të jetë krejt afër, apo, mos o zot, edhe larg. Krijimtaria krejt atë që e posedon, nuk është vetëm një shpalosje, nga ajo mund të dalin shumë fashe dhe kjo shpalosje mund të zgjas edhe më shumë. Shkrimtari ndërton lirinë e vet në veprën e tij, por një shtresë nuk e heton, apo thënë më mirë, nuk është në gjendje që ta absorbojë, kështu që krijohet një divergjencë ndërmjet Shkrimtarit si prodhues i Veprës artistike dhe lexuesit dhe ç'është më tragjike, ndërmjet studiuesit. Andaj, "shpikën" Metaforat si stade të refuzimit për t'i "qëruar" llogaritë me të gjithë ata që janë jashtë konvencave të konzumentit ditor. Shkrimtari (andaj edhe unë) "Lirinë" time prej shkrimtari mund ta konsideroj atë që arrij të ta pushtoj me veprën time, dhe vetëm ajo është në gjendje të më peshojë ç'luftëtarë i madh qesh-jam-isha. Është çështje në vete realizimi i Veprës, thënë pak më ndryshe, ofrimi i Veprës përpara opinionit, e më pastaj vjen vlerësimi i saj. Është vështirësuar një "kanalizim" i tillë, pikërisht për shkak të rënies së krejt asaj që ishte njëherë si format institucional. Tash, kur Krijuesit e mirëfilltë janë më të

ngathtë në plasimin e Veprave të tyre, mediokrët plasojnë hiçet e tyre dhe "përzihen" edhe "konceptet", ç'është ajo që vlen dhe s'është e publikuar, ndërmjet asaj që s'vlen dhe e ke para hundëve. Sikur të krijoheshin mundësi të tjera, që Vepra, akëcila Vepër të jetë e hapur, publike dhe të garojë edhe me atë që nuk është edhe gjithaq vlerë, atëbotë, një çlirim do të ishte edhe më i madh, se kriteri i zgjedhjes dhe shijes artistike do të jetë primar për t'u pranuar, për t'u rivalëzuar Veprat, e jo ky që ekziston (me pak përjashtime) sot, kur shundi, shkarravinat dhe pseudo-veprat letrare i mbushin raftet tona për t'u lexuar dhe për t'u vlerësuar (po qe se vlerësohen). Vërehet te ne pak i forcuar një politizim joproduktiv. Edhe Shkrimtarët më pak merren me vetvete e tyre, shumë më tepër me atë që ngjanë rreth tyre dhe botës përreth. Kjo është e kuptueshme, por një energji e shfrytëzuar vetëm në këtë mënyrë, droj se mund t'i bëj dëm si politikës, në përgjithësi, por se edhe vetë artit, në veçanti. Mungesa e Lirisë nuk duhet të keqpërdoret vetëm si "slogan". Po të ishim të lirë të gjitha do t'i rregullonim, shkasi duhet kërkuar arsye, për ndryshe do të jetë qëllim i vetvetes. Andaj për Shkrimtarin sot, edhe Metafora e djallit mund t'i shërbejë për ta krijuar Veprën e Djallit që i rri kundruall dhe ia zë hisen e tij të Diellit. Por, Metafora e Jetës Sime Është Vepra Ime, po qe se është Vepër- Metaforë.

(Beqir Musliu, 1945 - 1996, ishte poet, romancier dhe dramaturg. Musliu është autor i shumë veprave dhe shquhet për mjeshhtërinë e madhe të përdorimit të metaforave dhe simboleve, ndaj me të drejtë është konsideruar edhe si shkrimtar i simboleve).



Reflekse

## GJUHA SI MISTER

Materia e gjuhës është më e pasur se toka, qoftë ajo edhe e begatë me dëshmi të vjetra qytetërimi si toka helene apo ajo romane

Yzedin HIMA

Të gërmosh në gjuhë gjen thesare të paçmuara. Me anë të tyre mund të ndërtohet historinë e një vendi, mund të zbulosh kulturën e tij, sikurse arkeologu që gërmon në tokë dhe në nëndet për të gjetur dëshmi materiale për qytetërimet, beteja, mënyra jetese të shekujve të kaluar. Materia e gjuhës është më e pasur se toka, qoftë ajo edhe e begatë me dëshmi të vjetra qytetërimi si toka helene apo ajo romane. Natyrisht, të gërmosh në gjuhë kërkohen aftësi të mëdha njohëse të gjuhës, gjuhëve, kulturave, qytetërimeve. Nga leximi i "Iliadës" së Homerit, nga përshkrimi i qartë i vendndodhjes gjeografike të qytetit në tekstin e Epit u zbulua qyteti i Trojës nga Hainrih Shliman dhe kolegët e tij arkeologë. Me zbulimin e misterit që fshihej në gjuhë u vërtetua se Epi kishte një kontekst historik, nuk qe thjesht një

trillim.

Në ishullin Antiparos në Greqi gjendet një nga shpellat më të bukura të botës. Ajo u zbulua nga ambasadori francez në Kostandinopojë, markezi De Nouadel në vitin 1673. Kjo shpellë unikale në botë për stalagmitet e saj, në fakt kishte pasur një vizitor të parë shumë kohë më parë se të vinte markezi De Nouadel. Ai kishte qenë poeti nga ishulli i Parosit Archilochos, i cili ka jetuar në vitet 728-650 para Krishit dhe në një nga krijimet e tij e përmend shpellën e famshme. Misteri qe fshehur në gjuhë për shekuj të tërë, derisa një lexues i vëmendshëm si markezi De Nouadel, pasi lexoi tekstet e poetit antik vendosi të zbulojë atë, duke ia arritur qëllimit. Mund të sjellim mjaft shembuj të tjerë të mistereve të fshehura në gjuhë, por do ndalemi te njëri. Ne romanin e Nikolas Geixh ( Nikolla Gaxojanis) me titull "Eleni", në variantin anglisht, gjen një

fjali të tillë: "Go with me, zonia." (Eja me mua, zonjë). Fjala zonia nuk është fjalë e gjuhës greke, nuk është as fjalë e gjuhës angleze. Autori e shpjegon kuptimin e kësaj fjale po aty: "Eleni pleaded, using a village word meaning "kindswoman." (U lut Eleni duke përdorur një fjalë të fshatit që ka kuptimin "grua fisnike"). Natyrisht fjala zonjë në gjuhën shqipe ka kuptimin grua fisnike, sikurse me korrektesë e shpjegon edhe autori në gjuhën angleze. Po pse përdorej kjo fjalë dhe disa të tjera nga fondi i fjalorit të shqipes në një fshat homogjen grek? Kjo hap diskutime. Autori pohon se kjo fjalë përdorej në fshatin e tij, Lia, fshat në territorin grek pranë Kakavijës, pa thënë se cila ishte origjina e saj, gjë që na bën të besojmë se autori nuk e ka ditur origjinën e kësaj fjale. Edhe tek tekstet e shkrimtarëve që shkruan gjatë diktaturës ka mjaft të panjohura të fshehura në gjuhë.

Nëpërmjet leximit të kësaj gjuhe mund të zbulojmë dhe hedhim dritë mbi misteret e krijimit në diktaturë nga poetë dhe shkrimtarë të përndjekur nga sistemi totalitar. Censura, autocensura krijonte mjete dhe detale të gjuhës poetike, të cilat fshehin brenda formës së rafinuar mesazhin artistik e kuptimor. Po sjellim si shembull disa vargje nga poezia me titull "Ajsberg" e poetit Mihal Hanxhari:

*Ajsberg i vetmisë  
Kujtimi yt i bardhë flet me yllin e polit  
Po dëshpërimi yt i heshtur nën ujë  
Peshon peshon më shumë se qielli  
O peshk i vetëm  
ç'kërkon aq shumë në algat e zeza  
Syri yt si lule fushe ...*

Ky tekst, ashtu si ajsbergu, fsheh te vetja misteret e krijimit dhe mistere të tjera të mbulesës së teksteve për t'i ruajtur nga deformimi dhe keqpërdorimi.

# MOTRAT NGA QUMËSHTI: ANTIKULTURA DHE PËRSHPIRTSHMËRIA

Teknologjia në vetvete është produkt i kulturës njerëzore dhe ajo, nga ana tjetër, e çon kulturën njerëzore në rrënim. Së këndejmi, është e nevojshme të vëzhgohet sekuenca e atyre ngjarjeve ose supozimeve që e shtynë njeriun të shndërrojë mjetet e përmirësimit në një mjet për shkatërrimin e tij



## Metin IZETI

Antikultura është një tok idesh, vlerash dhe sjelljesh që kundërshtojnë kulturën mbizotëruese. Në kontekstin e modernitetit, antikultura shpesh interpretohet si një përgjigje ndaj ndjenjave të tjetërsimit dhe pakënaqësisë me shoqërinë dominuese.

Ka disa arsye për shfaqjen e antikulturës në modernitet:

1. Një nga arsyet është shekullarizimi. Shekullarizimi është procesi i ndarjes së fesë nga shteti dhe shoqëria. Në shoqëritë tradicionale, feja luajti një rol të rëndësishëm në formësimin e kulturës dhe vlerave. Megjithatë, në shoqëritë moderne, feja ka humbur ndikimin e vet. Kjo ka çuar në tjetërsimi të vlerave dhe kulturës tradicionale.

2. Një arsye tjetër për shfaqjen e antikulturës në modernitet është individualizimi. Individualizimi është një proces në të cilin njerëzit përqendrohen gjithnjë e më shumë në interesat dhe vlerat e tyre personale. Në shoqëritë tradicionale, njerëzit ishin më të lidhur me familjen, komunitetin dhe fenë. Megjithatë, në shoqëritë moderne, njerëzit janë gjithnjë e më shumë vetëm. Ata kanë më shumë liri në zgjedhjen e stilit të jetesës dhe vlerave të tyre, por janë të vetmuar. Kjo çoi në ndjenja të tjetërsimit dhe pakënaqësisë me shoqërinë.

3. E treta është urbanizimi. Urbanizimi është një proces në të cilin njerëzit lëvizin gjithnjë e më shumë në qytete. Në shoqëritë tradicionale, shumica e njerëzve jetonin në fshat. Megjithatë, në shoqëritë moderne, shumica e njerëzve jetojnë në qytete. Qytetet janë shpesh mjedise ku takohen kultura dhe ide të ndryshme. Kjo çoi në ndjenja konfuzioni dhe pasigurie.

## Antikultura inicon dhunë, krim, degradim

Antikultura mund të shfaqet në forma të ndryshme. Disa nga format më të zakonshme të antikulturës në modernitet janë:

a) Subkulturat, që janë grupe relativisht të vogla njerëzish që ndajnë interesa dhe

vlera të përbashkëta. Subkulturat shpesh kundërshtojnë kulturën dominuese përmes mënyrës së veshjes, muzikës, sjelljes, etj.

b) Kultet, që janë grupe njerëzish që besojnë në ide ose vlera të caktuara që ndryshojnë nga ato dominuese në shoqëri. Kultet shpesh konsiderohen të rrezikshme sepse mund të nxisin dhunën ose vetëdëmtimin.

c) Lëvizja hippy, që ishte një lëvizje që filloi në Shtetet e Bashkuara në vitet 1960. Lëvizja hippy ishte kundër vlerave dhe kulturës tradicionale. Hippit shpesh përfshiheshin në protesta paqësore, eksperimentonin me drogë dhe me sjellje liberale gjinore.

ç) Lëvizja punk, që ishte një lëvizje që filloi në Mbretërinë e Bashkuar në vitet 1970. Lëvizja punk ishte kundër materializmit dhe konsumerizmit. Punkët shpesh përfshiheshin në dhunë dhe vandalizëm. Antikultura pati një ndikim të rëndësishëm në kulturën moderne. Antikultura nxiti ndryshime në kulturën mbizotëruese si dhe në mënyrën se si njerëzit mendonin për botën. Nga njëra anë, antikultura inkurajoi të menduarit kritik për vlerat dhe kulturën mbizotëruese. Antikultura ishte gjithashtu një burim i ideve dhe vlerave të reja që ndihmuan në formimin e koncepteve alternative kulturore që nuk pajtoheshin me konceptin e shoqërive moderne.

Nga ana tjetër, antikultura ishte një forcë që ndikoi në paraqitjen e anomalive shoqërore në modernitet. Ajo e incioi dhunën, krimin dhe probleme të tjera. Si rrjedhojë mund të themi se antikultura është një fenomen kompleks dhe i shumanshëm. Mund të jetë një forcë pozitive ose negative në shoqëri. Antikultura është pjesë e modernitetit, vazhdon të ketë një ndikim të rëndësishëm në kulturën moderne. Antikultura shfaqet shpesh tek të rinjtë. Kjo për shkak se të rinjtë shpesh ndihen të tjetërsuar nga shoqëria dominuese. Antikultura në të shumtën e rasteve manifestohet përmes muzikës dhe artit. Muzika dhe arti janë shpesh mënyra për të shprehur pakënaqësinë me shoqërinë dominuese.

## Teknologjia si rrënuese e kulturës

## njerëzore

Në një masë më të madhe ose më të vogël, siç shihet edhe nga këto koncepte, njeriu përballlet me vuajtje të caktuara. Nuk është e mundur të numërohen në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha "llojet" e vuajtjeve, as vuajtjet e çdo qenie njerëzore që jeton në botë - por ajo që është e përbashkët për të gjithë dhe "vuajtja" e pashmangshme është vdekja e sigurt biologjike. Çështja e shëndetit, çështja e luftës dhe çështja e urisë në historinë e qytetërimit njerëzor janë shfaqur deri diku si probleme të zgjidhshme. Megjithatë, çështja e vdekjes biologjike mbetet ende një mister i pazgjidhshëm për njeriun dhe për këtë arsye është një shkak unik i vuajtjeve. Vdekja e përballon njeriun me çështjen e kuptimit, me çështjen e origjinës dhe qëllimit të tij përfundimtar. Siç është formuluar qartë nga Hans Küng, "çdo 'siguri filozofike ose metafizike' duhet të konsiderohet në sfondin e pasigurisë themelore ekzistenciale të mbijetesës njerëzore" pasi ai nuk mund t'i ikë kohës së vdekjes. Modernizmi nuk mendon për këtë paradoks të vdekjes, por beson se njeriu mund të arrijë potencialin e plotë të jetëgjatësisë së tij përmes arritjeve mjekësore dhe teknologjike, por në fund ndodh një paradoks tjetër - shkencën dhe teknologjinë çojnë në një njeri teorikisht të pavdekshëm, por praktikisht të vdekshëm. Siç shpjegon Harari, me një sërë shembujsh, teknologjia do të zëvendësojë veprimtarinë njerëzore në epokën e kompjuterave, në të cilën ndodhet shoqëria jonë dhe do të përpiqet gjithnjë e më shumë në drejtim të majes së saj. Qëllimi i çdo aktiviteti njerëzor, dhe më pas i teknologjisë, është që t'i mundësojë njeriut të përsosë veten dhe të përmirësojë kushtet e jetës duke zhvilluar kulturën përmes veprimtarisë së tij dhe në të njëjtën kohë duke lejuar kulturën ta formësojë atë. Sipas Arnold Gehlen, kultura është një kompensim për deficitin morfologjik të natyrës njerëzore, është çdo ndërhyrje njerëzore në ndërtimin e një bote specifike njerëzore. Por kjo buron nga natyra shpirtërore e njeriut, e cila është një aspekt pozitiv i kulturës. Meqenëse Harari e sheh teknologjinë dhe

shkencën si një mënyrë çlirimi nga vuajtjet, duke marrë parasysh atë që u tha më parë, mund të themi se lloji njerëzor, i cili është nën kërcënimin e tjetërsimit, teknikat e zhvillimit të vazhdueshëm dhe të pakontrolluar, vendos vetë veten në një gjendje anti-kulture - shkatërrimi të veprimtarisë njerëzore, shkatërrimi të shpirtit njerëzor. Kështu arrijmë në një absurditet: teknologjia në vetvete është produkt i kulturës njerëzore dhe ajo, nga ana tjetër, e çon kulturën njerëzore në rrënim. Prandaj, është e nevojshme të vëzhgohet sekuenca e atyre ngjarjeve ose supozimeve që e shtynë njeriun të shndërrojë mjetet e përmirësimit në një mjet për shkatërrimin e tij.

## Antikultura si prodhim i marginalizimit kulturor

Kësisoj, çështja e së vërtetës pushon së qeni vetëm një çështje e njohjes së realitetit objektiv, por bëhet çështje e ekzistencës së njeriut. Atëherë njeriu nuk mund të privohet plotësisht nga subjektiviteti i tij, ashtu siç nuk ka dualitet tek njeriu dhe një ndarje e rreptë në procesin e të menduarit që do të ndante subjektiven nga objektiviteti. Fakti që ekziston kanceri, në vetvete është i tmerrshëm, sepse njerëzit si kolektiv, bazuar në përvojën dhe ekzistencën e tyre, e interpretuan atë si negativ. Një person nuk mund të privohet nga përvoja e tij dhe ta vëzhgojë atë përvojë si diçka të veçantë nga njeriu, sepse ai nuk do të ketë një pasqyrë të plotë, ai nuk do të jetë në gjendje të interpretojë të dhëna të caktuara pa përvojat e njerëzve të tjerë që ishin çelësi i interpretimit të atyre të dhënave.

Duke u përqendruar në kulturën dominuese dhe antikulturën e shfaqura si pasojë e kulturës dominuese, që bashkërisht e prodhuan teknohumanizmin dhe përparimin e pakufizuar njerëzor, "njeriu i ri" synon të provojë se realizimi i lumturisë së përgjeshme, hyjnisë, pavdekësisë, fuqisë, shëndetit dhe aftësive që ishin të pamendueshme deri para disa dekadave është brenda mundësive të vetë njeriut. Por apologjia e këtij koncepti përfundon në një apokaliptë robotike, në të cilin njeriu humbet kontrollin mbi evolucionin e tij, por edhe mbi ekzistencën e tij, duke vënë në dyshim mbijetesën e qytetërimit njerëzor. Në fakt, kjo mendësi nuk ofron zgjidhje për problemet me të cilat është përballur njeriu në histori. Supozimet e Hararit, të cilat bazohen në antropologjinë algoritmiko-dataistike, e reduktojnë njeriun në l'homme machine dhe i jep fund çështjes së kuptimit të ekzistencës së tij. Duke u nisur nga një pozicion i tillë, shihen qartë mangësitë e kulturës dominuese dhe antikulturave të krijuara nga margjinat e kësaj kulture. Si pasojë, një gjendje e këtillë hap mundësinë e aktualizimit të mesazhit fetar në kohën e teknohumanizmit duke e bazuar në mendimin e revelatës dhe antropologjinë e traditës konstituive fetare. Ka autorë që mbrojnë transhumanizmin radikal si dhe të tillë që e shohin teknokracinë si një mjet të hirit të Zotit dhe një fazë drejt realizimit eskatologjik, pra zhvillimit të plotë të personit njerëzor si "imazh i zotit" pa Zot. Teknologjia, si edhe mjetet e tjera të shpikjeve njerëzore, mund të përdoren për të përparuar dhe për dashurinë e vërtetë për njeriun, por mund të bëhet edhe një instrument i decentralizimit dhe degradimit të njeriut. Gjithçka varet nga qëllimi i saj, dhe pikërisht për këtë çështje

kuptimi fetar i transhumanizmit dhe kulturës mund të jetë i dobishëm sepse feja e di se cili është qëllimi përfundimtar i krijimit, dhe kështu i përgjigjet pyetjes së dobisë përfundimtare të teknologjisë.

**Arti si mjet që flet për frikën njerëzore**

Arti, qoftë i përshkruar si pasqyrim i kulturës së lartë apo popullore, e thekson veten sot, ndoshta më shumë se në të kaluarën - po aq sa shkencat humane edhe teologjia - e ndjen veten të aftë për të interpretuar kuptimin e jetës dhe për të

komunikuar përvoja të thella shpirtërore dhe fetare njerëzore. Që në fillimet e njerëzimit, arti si shprehje e gjenialitetit krijues dhe estetikës për të cilën njeriu aspiron, shoqëron dhe shpreh kërkimin e vazhdueshëm të kuptimit. Në kuptimin tradicional të shkencës, në periudhën nga shekulli i 17-të deri në shekullin e 20-të, ajo pothuajse u përjashtua nga kërkimet empirike dhe vetëm nga gjysma e dytë e shekullit të 20-të, disiplinat shkencore e pranuan artin, në kuptimin e tij më të gjerë, si lëndë dhe burim kërkimi. Krijimet artistike sot janë gjithnjë e më

shumë produkte dhe pasqyime të kulturës popullore dhe në një farë mënyre pasqyrojnë gjendjen e shpirtit njerëzor në shekullin e 21-të. Piktura, muzika, filmi dhe letërsia e sotme flasin shumë për frikën dhe shpresat që preokupojnë njeriun modern, i cili ndoshta më shumë se kurrë ka nevojë për Zotin dhe spiritualitetin edhe pse e refuzon me fjalë. Këtë e tregon përmes temave dhe formave që në pamje të parë mund të duken larg fesë, por në fakt janë një thirrje për kuptim. Ja pse teologjia dhe, në përgjithësi, shkencat humane e

shoqërore, janë thirrur të studiojnë shprehjet e kulturës në të cilën jetojnë, të cilat shumëkush i "përthith" çdo ditë përmes medias, të cilat janë pasqyrim i vlerave dhe nevojave të njeriut modern. Inteligjenca e një orientimi fetar mund të kontribuojë në shërbimin e kulturës dhe botës, jo vetëm nëpërmjet krijimit të historive imagjinare dhe veprave të tjera të artit brenda një kulture, por edhe duke vlerësuar në mënyrë kritike ato vepra të kulturës që përfaqësojnë, në mënyrë implicite ose eksplicite, thelbin dhe perspektivën ekzistenciale.

Ese

# SHPRESA SHKRUAN VETËM PËR DASHURINË

Dikur për dashurinë shkruanin poetët, ndërsa poeteshat në erotikë shfaqeshin thujtë si murgësja, ngaqë i ndruheshin opinionit

**Fatbardh AMURSI**

Lexo sa të duash libra, shih filma po aq, ndodh që personazhet të fshihen nga kujtesa, ndërsa çunat dhe gocat e lagjes së vjetër mbeten për gjithë jetën, sikurse abetarja krahasuar me librat që do të bjerë rasti të shfletosh ndër vite. I mbaj mend të gjithë dhe me askënd nuk më ndodhi të isha i zemëruar, sikurse do ngjiste me shoqëritë e mëvonshme. Shkak të kthehesha në "motin e shkuar", u bë fotoja e nënës së Shpresa Dhimes, Kristina, e cila i gëzohej librit të vajzës së saj. Këtyj gëzimi po i bashkohem dhe unë me këtë shkrim. Çupën e lagjes së vjetër, pas shumë vitesh, do e shihja të postonte në facebook poezi, shpesh të vlerësuar me çmime dhe certifikata nderi, së cilës i shtoheshin vazhdimisht miqtë. (Krahas Shpresës janë nderuar me certifikata dhe çmime autorë lushnjarë, si: Kujtim Hajdari, Bujana Xhindoli, Elona Tabaku, etj.)

Dikur për dashurinë shkruanin poetët, ndërsa poeteshat në erotikë shfaqeshin thujtë si murgësja, ngaqë i ndruheshin opinionit, që në provincë dozat e ndotjes me konservatorizëm i ka ku e ku më të larta nga metropolet. Ndërsa sot raportet kanë ndryshuar. Janë poeteshat, që, si fshehin asgjë shpirtit, ndërsa poetët më së shumti kamuflohen. Sot shumë prej poeteshave shkruajnë nga kryeqytetet e botës, llogariteni si favor këtë, por, ndodh që ato në provincë të jenë edhe më kurajoze, sikurse dëshmon dhe ky varg i njëres prej tyre: "Mbas fjalës bymehem, derdhem, përmytjem". (Lexoja këto ditë një shkrim të Kristo Mërtirit: "80-vjeçarja libohovite që shkruan për dashurinë" apo në Chicago promovohet libri i Mirela Kaninit "Për pak dashuri".) Tek poeteshat e dashurisë renditet dhe Shpresa Dhima. Në poezinë e saj has vetëm një hero lirik, më së shumti i shfaqur si imazh dhe me raste, një trupëzim pasionesh, të cilit ajo i përkushtohet deri në pagjumësi. (Nëse në rini ai shfaqet si një "princ i kaltër", tani duket si i zhveshur nga titujt e fisnikërisë.) Më shumë se sa i pranishëm, për të ndarë çaste erotike me të, ai është i munguar. Pikërisht ky "i munguar" mban gjallë shpirtin e saj, duke mos rënë në platonizëm. Në këto raporte ndodh, që në vargje të ketë më shumë ikje se sa pritje, ku, pritja, rezulton të jetë më torturose nga brengosja e ikjes. Në

librin "Autobiografia e popullit në vargje" Kadare vë re këtë paradoks tek e shkuara: "Nëse në jetë dashuria ishte e ndaluar në këngët popullore ajo ishte e pranishme." Kjo prani e dashurisë në poezi, në kohën e sotme krijon kontrast me realitetin, ngaqë tek e përditshmja pragmatiste, mirëmëngjesi me interes, dashuria sa vjen e zbehet, për më tepër që realiteti është i mbarsur me urretje, hakmarrje, konflikte, tinzarllëqe. Njerëzit po dashurohen vetëm nëpër libra, si një nevojë për të kompensuar mungesën e saj tek e përditshmja.) Kështu që erotika më shumë se sa dashuri shfaqet si pakënaqësi. Edhe tek Shpresa, si tek vjershëtoret e tjera: dashuria shihet si vuajtje, brengosje, "ti je loti im", ku ndjenja e pritjes, sfumohet nga ajo e ikjes. Heroina pret, që ta zgjoj agimeve, mes puthjeve dhe lotëve. "Pret një fjalë, një dritare çelur"-varg i saj. Tek një lule sheh fytyrën e tij, nga që kalorësi ikën në drejtim të paditur. "Trokitjet e kalit zënë afrohen./Por, për çudi asnjë nuk kalëron"-varg i Shpresës, sepse mungon kalorësi. Dashuria ka humbur fshehtësinë, sikurse e thotë Lasgushi: "Një dashuri-një fshehtësi/Më e fshehur se sa fshehtësia". Video-përgjimet po kthehen në mjete shantazhi. Kur këmba e njeriut shkeli në Hënë, ajo e humbi romantizmin. Vazhdimisht ndjen trokitje hapash, ngaqë rri e pagjumë dhe do të flierë në sytë e tij, që ndoshta në ato çaste është duke gërhitur. "Kush vargun e saj s'e lexoi/Kush me atë varg s'u dashurua."-shkruan në poezinë me titull "Poetes së dashurisë", sikurse e cilëson dhe redaktorja e librit në parathënien përkushtuese. Ndoshta kjo është arsyeja që librin e titullon "Dhuratë vetes për ditëlindje". "Unë të kam dhënë dhurata, Ofeli?"-e pyet Hamleti, "Po, Imzot, duke m'i shoqëruar me fjalë aq të bukura, sa m'i bëre ato dhe më të shtrenjta!"-Por, Hamletit mendja i punonte si e si të merrte hakun e babait dhe jo si t'i jepte dashuri Ofelisë. Edhe pse të një lagjeje me Shpresën, tani na ndajnë kontinente dhe oqeane. Unë në Amerikë dhe Shpresa në Itali. Kishte dëshirë t'ma dhuronte librin, që, në fakt, më parë: ia kishte dhuruar vetës. Qëlloi të isha në vendlindje, kështu që ia shkurtova rrugën librit për të ardhur tek unë. A mund ta lija unë të zemëruar, gocën e lagjes, duke prishur rregullin e miqësisë të brezit tim?



# AUTORËSIA E VËRTETË E ROMANIT "TRADHËTIA"

(Rreth librit "Tradhtia e shumëfishtë" e poetit, prozatorit, gazetarit dhe publicistit Fehmi Ajvazi, Botoi "Lena Graphic", Prishtinë, 2023)



Sylejman KRASNIQI

Nga e kaluara jonë kemi trajtuar shumëçka, ashtu siç shumëçka edhe kemi mbetur pa e trajtuar. E kjo na shtynë të gjykojmë se një pjesë të historisë ne nuk e njohim. Arsyet janë nga më të ndryshme, ashtu siç ka edhe pa arsye, neglizhencë, mbyllje në koncepte dhe procese, mungesë guximi, bashkëveprimje etj. Akte e veprime, ngjarje, procese etj., janë të pazbërthyer. Disa do të treten pa gjurmë në mungesë të hulumtimit dhe në mungesë të dëshmi, fakteve, të dhënave konkrete nga terreni historik. Autori Fehmi Ajvazi, i ka hyrë një pune mjaft të vështirë, delikate, të pa lëvruar deri tani nga askush, por mbi të gjitha, i ka hyrë një shtegu të guximshëm, sepse i është dashur të depërtojë nëpër labirintet të rrezikshme të shërbimeve sekrete të ish-Jugosllavisë. Në vorbull të hulumtimit, atij i kanë munguar për një kohë të gjatë të dhënat dhe faktet, por ka qenë intuïta dhe përvoja ato që kanë ndikuar që z. Ajvazi, të mos heqë dorë nga shkrimi i këtij libri të rrallë në literaturën shqipe.

I ndodhur në mes të dy botëve të kundërta, autori e ka kuptuar se "bota e mirëfilltë" dhe "bota kriminale" e kanë dominuar gjeografinë, që domethënë banorët e saj: shqiptarët! Do të thoshim, nuk ka popull në botë që ka përjetuar më shumë dhunë, terror dhe barbari më shumë se populli ynë, madje në mënyrë sistematike nga armiq të ndryshëm dhe ne, sot e kemi shumë të vështirë që ta shkruajmë historinë tonë. Prandaj, edhe e kemi të vështirë që t'i hulumtojmë, faktet, krahasojmë etj., dy botët e shekullit XX që e kanë dominuar gjeografinë e shqiptarëve: ajo autoktone, dhe tjetra bota sllave e që ne, e nënkuptojmë kryesisht si "bota serbe"! Libri "Tradhtia e shumëfishtë", është e natyrës së terrorit, spionazhit dhe e kriminit të organizuar kundër shqiptarëve dhe kundër çdo gjëje shqiptare nga nivele të larta - të organizuara, si në kohët e mbretërisë serbe dhe si në kohën e ish Jugosllavisë komuniste. Duke e lexuar këtë libër, natyrisht më ngadalë dhe duke pasur edhe njohuri të përgjithshme paraprake, e kuptojmë rolin e autorit në qasjet e tij, në konceptet dhe hulumtimet e tij. Përmbajtja e librit bazohet në një histori reale. Nuk ka asgjë të improvizuar, artistike, estetike: në rreth 300 faqet e librit, zëbërthet një projekt agjenturorë i shërbimit sekret ushtarak jugosllav, i cili ka për qëllim luftën sistematike kundër shqiptarëve dhe zgjerimin territorial ekspansionist serb dhe jugosllav në viset jugore të gadishullit ballkanikë.

Dekonspirimi i vështirë i një tematike agjenturore

Autori, duke e hulumtuar bërthamën e temës së tij, na sjellë "dy personazhe" mes të

cilëve, në distancë, zhvillohet një betejë për jetë e vdekje! Këta dy personazhe nuk janë njohur dhe as nuk janë takuar kurrë, por njëri është shqiptarë dhe tjetri serb. Njëri përfaqëson interesin dhe identitetin e kombit të tij, dhe tjetri, përfaqëson interesin dhe politikën e shtetit të tij! Deri sa i pari, Haki Limani, është një personazh sporadik (në ardhje e sipër - ende i pa ekspozuar), i dyti, Kapllan Resuli, është një personazh në sfocim e sipër, i cili ekspozohet gjithnjë e më shumë në publik.

Të dy janë në rolin e shkrimtarit: por, Hakiu sapo ka filluar të shkruajë dhe atë në mënyrë të fshehtë dhe Kapllani, i cili ka filluar të shkruajë, por që nuk ka lidhje me këtë dhunti e zanat. Ai është i përgatitur si agjent sekret, ndërsa që i mundësohet të nënshkruan tregime e novela, shkrime të cilat me urdhër dhe mbikëqyrje të pushtetit, i shkruajnë të tjerët në emër të Kapllanit. Ballafaqimi në mes të Haki Limanit, një intelektual i nivelit ta lartë akademik në formim e sipër nga Tërnavë e Preshevës, i cili jeton dhe vepron në Prishtinë, dhe në mes të Kapllan Resulit, një oficer i KOS-it jugosllav, i cili endet atje - këndeje në territorin e Jugosllavisë, është detyrim i autorit Fehmi Ajvazi për ta hulumtuar, krahasuar, sistemuar dhe analizuar të vërtetën tematike. Pa këtë "ballafaqim" është e pamundur që të shpalohej "e vërteta", gjithsesi përmes gjetjes dhe zëbërthimit edhe të shenjave, dokumenteve dhe të dhënave autentike mbi krejt përmbajtjen e librit.

Autori në fjalë, duke e pasur parasysh përvojën e tij, të kaluarën, leximin dhe sidomos informacionin e tij, guxon t'i rrekët shkrimin të këtij libri. Ndonëse fillimisht i mungojnë "dëshmitë dhe faktografitë", atij nuk i mungon hulumtimi, mbledhja dhe grumbullimi i materialit bazë për librin. Duke ditur ta zëbërthet dhe studiojë materialin e grumbulluar (autori është ish gazetar, politolog dhe shkrimtar), z. Ajvazi përdorë me kujdes edhe metodat e ndryshme shkencore. Autori, një kohë të gjatë dyshon, mbase me vite të tëra dhe pastaj përpjetat ta zbulojë autorin e vërtetë të romanit të njohur historik "Tradhtia". Romani, së pari është botuar në vitin 1965 në Tiranë, pastaj është ribotuar në vitin 1967 në një tirazh prej 20 000 kopje. Është një nga romanet më të mirë historik në letërsinë shqipe.

Botimi i këtij romani aso kohe kishte pasur jehonë të madhe dhe ishte pritur me interesim të jashtëzakonshëm. Deri sa në Shqipëri ky roman ishte lexuar në mënyrë legale, në Kosovë dhe në viset e tjera, ishte lexuar në mënyrë të fshehtë - ilegale, meqë shërbimet jugosllave e kishin trajtuar me automatizëm si roman me karakter anti-jugosllav. Pra, "historia" e romanit si tekst është e komplikuar. Por, edhe më e komplikuar i ishte dukur z. Ajvazit historia e shkrimin të romanit, në të vërtetë "autorësia" kur ky e kishte lexuar romanin "Tradhtia" në vitin 1993. Siç e cekë edhe vetë autori, menjëherë pas leximit të romanit dhe pasi e lexon biografinë e autorit (Kapllan Resuli), shfaq dyshime për autorësinë e romanit në fjalë.

Por, pse shfaq dyshime autori? Sepse, z. Ajvazi ka lindur dhe ka jetuar një kohë të gjatë në territorin ku zhvillohen ngjarjet në roman, në vendbanimet prej nga janë personazhet e romanit, dhe siç e thotë jo njëherë, ishte rritur me "tregimet" për ta, me ngjarjet që saktësisht përshkruhen në roman. Ky territor, është regjioni i Karadakut. Në cilësinë e gazetarit, por edhe si krijues, para vitit 2000, z. Ajvazi ishte përpjekur të thoshte diçka mbi këtë "tregim", ndërsa që ishte koha kur Kapllan Resuli, si shkrimtar, ishte i paprekshëm në letërsinë shqipe.

Dyshimi i z. Ajvazi rritet edhe më shumë kur në shtypin e kohës, paraqitet Nafi Çergani (një ish operativist i zellshëm i UDB-s jugosllave në Shkup), i penduar publikisht që kishte punuar për shërbimin jugosllav. Ai e vë në dyshim autorësinë e Kapllan Resulit për romanin "Tradhtia", meqë dëshmon se e ka pasur në sirtarë dosjen e tij në UDB-në e Shkupit. Është e pamundur, thotë autori, Fehmi Ajvazi, që një ulqinak (Kapllan Resuli ishte i lindur në Ulqin), pa pasur asnjë lidhje me anën e Karadakut të Gjilanit, ta njohë aq mirë atë terren, ata njerëz, ato vise dhe atë mentalitet, sikurse janë përshkruar në roman. Këtë mund ta bëjë vetëm njeriu i asaj ane, ose njeriu që ka pasur lidhje shumë të forta emocionale, organizative, miqësore etj., me atë zonë! E këto të gjitha i kanë munguar Kapllan Resulit, njeriut të UDB-së - KOS-it jugosllav. Në hulumtimin, analizën dhe studimin e hollësisht të personazheve, ngjarjeve dhe botës së errët të konspiracionit dhe agjenturave, Fehmi Ajvazi, i zëbërthen të gjitha variantet e mundshme për autorësi të romanit dhe ndalet, sipas mendimit tim, në të vetmen mundësi të autorësisë: te personi Haki Limani. Sepse prej të gjithëve që janë përmendur shkarazi për autor të mundshëm të romanit, i vetmi është Haki Limani i cili, mund ta shkruante atë libër me të gjitha ato të dhëna të sakta për atë terren dhe për ata njerëz.

Personazhi Haki Limani

Është e pamundur që me pak fjalë, me pak faqe të shpjegohet tematika e këtij libri, i veçantë për nga natyra dhe përmbajtja. Mirëpo, më e pakta e pakta e "përmbajtjes" së këtij libri, na ndihmon të informohemi se shteti jugosllav, i dominuar nga serbët, ka vepruar ditë e natë kundër shqiptarëve. Në Beograd janë hartuar plane e projekte, siç është edhe ky rast ku shteti qëndron mbrapa një plani të rrezikshëm me dimensione shkatërruese. Ky plan ku Kapllan Resuli ka qenë në krye, ka mbetur në tentativë. Por, krahas dekonstruktimit të planit, ne arrijmë të kuptojmë se, si janë zgjedhur, hartuar dhe zbatuar objektivat kundër shqiptarëve. Në libër janë "dy personazhe" me role të kundërta, diametralisht të kundërta dhe unë them se autori Fehmi Ajvazi, ia ka arritur qëllimit në zëbërthimin e enigmës së autorësisë të romanit "Tradhtia". Duke e zëbërthyer këtë "enigmë", e kuptojmë fatin tragjik të popullit shqiptarë, e më konkretisht, të autorit të vërtetë të romanit, Haki Limani. Pra, kemi të bëjmë me zhvillimin e një drame të vërtetë agjenturore që, në rrethanat normale, duket si një dramë ireale! Duke e lexuar më tej librin e z. Ajvazi mbetet ende enigmë se si ka arritur romani nga Haki Limani deri tek Kapllan Resuli. Këto që i thotë z. Ajvazi, janë ende gjykime, pa ndonjë argument bindës. Por, është normale, sepse ende është shumë i vështirë vërtetimi me fakte të mirëfillta i mënyrës së marrjes (vjedhjes) së romanit nga Haki Limani dhe dhënia e autorësisë Kapllan Resulit. Ajo që dihet është se Hakiu i likuidua nga shërbimet jugosllave gjashtë muaj pas botimit të romanit në Tiranë, ku ndodhej Kapllani si "i ikur politik apo si armik i Jugosllavisë". Në të vërtetë, Kapllani ishte një agjent sekret jugosllav dhe jo një shkrimtar! Zbulimi bëhet edhe më i vështirë kur dihet se as Haki Limani dhe as Kapllan Resuli nuk janë sot mes të gjallëve, por as bashkë kohanikët e Haki Limanit nuk janë ndër ne. Edhe ata pak bashkëkohanik ose "shokë" të Hakiut që ende janë gjallë, e kanë mbyllur gojën me kohë dhe nuk flasin. Apo ndoshta dëshira e tyre është që kur të shkojnë në "dynjanë" tjetër, t'ua kumtojnë të vërtetën vetëm Hakiut dhe Kapllanit!

Autori, Fehmi Ajvazi, ka bërë përpjekje aq sa ka mundur, për ta zbuluar mënyrën e "shkuarjes" së romanit nga Hakiu Limani tek Kapllani Resuli, por nuk ka mundur të hyjë më thellë në labirintet e fshehta të UDB/KOS. Është munduar që nëpërmjet aktit të aksidentit me makinë, e cila e vrau Hakiun ditën e 26 dhjetorit të vitit 1965 në Prishtinë, të hapet një derë për gjetjen e mënyrës së marrjes së dorëshkrimit të romanit nga Haki Limani, por, si duket, skenari i grabitjes së romanit dhe i likuidimit të Hakiut ka qenë tejet i sofistikuar sa që edhe skenaristi më i përgatitur i nivelit të Hiçkokut, do ta kishte vështirë ta zëbërthente pa posedimin e "dosjes" agjenturore jugosllave të Haki Limanit, e cila duhet të jetë në arkivat ushtarake në Beograd.

Me aktin e vrasjes së Haki Limanit dhe të marrjes së romanit, pushteti serbë i ka arritur dy qëllime: e ka nxjerrë në sipërfaqe dhe e ka faktorizuar "Kapllan Resulin" si shqiptar të "devotshëm e patriot", si shkrimtar shqiptar me ide të "pasura" dhe të njëjtin, e "shiti" si pjesë të kolonës së pestë në Shqipërinë londineze. E nga ana tjetër, e likuidoi një shqiptar të nivelit akademik, të pakrahasueshëm për kohën, një shkrimtar kulmor në ardhje e sipër dhe me perspektivë në letërsinë shqipe: Haki Limanin. Mjafton të përmendet romani "Tradhtia" (sado që ishte me autorësi të rreme), i cili bëri jehonë të jashtëzakonshme në Shqipëri dhe në Kosovë si asnjë roman tjetër i botuar pas Luftës së Dytë Botërore. Edhe pse i botuar pas romanit "Gjarpitë e gjakut" të Adem Demaqit, katër vite pas romanit të Azem Shkrelit "Karvani i bardhë" etj., romani "Tradhtia" pati jehonë shumë më të bujshme në të gjithë hapësirën shqiptare.

Çudia shqiptare!

Nga Haki Limani pritej shumë, por atij iu pre rrugëtimin intelektual e shkencor në mes. Për këtë punë shumë delikate, të guximshme e të pakursyer, vlen të përgëzohet autori Fehmi Ajvazi. Me këtë punë të mundimshme dhe të palodhshme, autori e ka zhveshur tërësisht Kapllan Resulin (Resulbegoviqin) nga puna e tij antishqiptare: që nga arratisja e tij në Shqipëri në vitin 1960 dhe deri tek përgatitja e planeve për një kryengritje në Kosovë në vitet e 70-ta. Në pyetje ishte një plan i trisht serbo-jugosllav për dominim absolut në Kosovë, e më pastaj edhe në Shqipëri. Pra, s'ka dyshim që Kapllani s'ishte shkrimtar, por një agjent i shërbimit kundër informativ jugosllav, dhe kjo dëshmohej edhe në këtë libër. Pikërisht për tentativat e këtilla, Kapllani u arrestua në vitin 1970 në Tiranë dhe u dënua me 20 vite burg. Dënimi i tij, s'kishte lidhje me romanin "Tradhtia" dhe as me likuidimin e Haki Limanit!

Haki Limani ishte viktimit e planit, pjesë e rastësishme e një skeme të shumëfishtë agjenturore. Dorëshkrimi i tij u përdor për ta mbuluar dhe faktorizuar figurën e Kapllanit rreth një misioni, që s'kishte lidhje me shkrimin dhe letërsinë. Për fat të keq, i ndihmuar edhe nga rrethanat politike dhe historike, ashtu si edhe nga mungesa e njohjes dhe e zëbërthimit të këtyre rrethanave nga vet ne, Kapllan Resuli si para se të burgosej në Tiranë në vitin 1970 dhe si pas daljes nga burgu në vitin 1990, u trajtua si një shkrimtarë shqiptar. Madje, me mjaft përdëllesë e mirënjohje nga vet shqiptarët! Por, ai ishte një serb që jetoi rreth 60 vite në mesin e shqiptarëve, edhe pse kishte deklaruar disa herë se nuk ishte shqiptar! Kapllan Resuli vdiq më 11 gusht të vitit 2022 në Gjenevë dhe u varrosë me ceremoni kishtare në kishën serbe "Sveti Nikolla", në Ulqin.

# KONCEPTI I LIRISË SI QËLLIM DHE KREDO E PËRHERSHME

(Rreth vëllimit poetik "Enigma e vijave" të Hekuran Halilit)

Agim BAJRAMI

S'di pse më ngjajnë poezitë e Hekuranit si një grumbull pikturash të ndezura, ku ngjyrat dhe lëvizjet, në pamundësi për ta përmbajtur vetveten, fillojnë të thyejnë kornizat dhe të ribëjnë vetveten edhe nëpër mure. Mendimi im parësor shkon në shumë hipoteza, por unë më shumë i mëshoj idesë se brenda formës dhe përmbajtjes se tyre, autori ka shpërfaqur artistikisht copëza të shqetësuara të vetvetes së tij, në bërje dhe zhbërje, dhe çka është më e rëndësishme, në një moment rishqyrtimi të arsyes së ekzistencës së tij në këtë botë. Janë gjendje që të gjithë ne i kemi brenda vetes, por që Hekurani ka ditur t'i formësojë dhe t'i pasqyrojë ato në versione të ndryshme.

Edhe më parë e kam njohur krijimtarinë e tij, që nga "Unë njeriu", "Bukë me Hënë", e gjer te tregimet e tij aq tronditës me problematika të mprehta sociale dhe historike. Janë poezi spontane, por që kanë ditur të marrin nga realiteti esencën dhe thelbësoren. Autori ka një këndvështrim krejt të tijën për ato që merr përsipër të trajtojë. Vargjet e tij duket se formësohen dhe bëhen të gjallë prej prekjës dhe të komunikimit të pazëshëm.


Kjo, se nënteksti është një pjesë e stilit të poetit. Duke qenë tip meditative, autori i vesh vargjet e tij me një tist të hollë filozofie, që kërkon një përqendrim dhe kohë të posaçme leximi. Ai e merr në duar momentin dhe pasi e kundron atë nga shumë kënde, vendos ta vërë para lexuesit në një mënyrë të natyrshme, nëpërmjet shkrirjes brenda tyre të ekzistencializmi, futur pak nga ajo magmë malli dhe mospajtimi për atdheun e tij të mohuar fiziologjik, që ndonëse konsiderohet mollë e ndalume, vazhdon të lëvizë brenda tij si një dëshirë e përgjeshme.

Bir i një çami të shpërngulur me dhunë nga trojet stërgjyshore, që mbylli sytë me qepalla të rënduara nga malli për rikthim, e shtyn atë ta shndërrojë vargun e tij shpesh në një zog amaneti. Ai fluturon nëpër net mbi rrënojat e muret e mbetura të shtëpisë së tij, si për t'ju thënë atyre se asgjë nuk ka humbur, se asgjë nuk është shuar, se bijtë vazhdojnë të jenë atje, mbas atij kloni të mallkuar prej urretje dhe krimesh të përbindshme, dhe se ata dikur do të vijnë për t'i prishur dhe zhdukur përgjithmonë.

Unë që e njoh karakterin dhe natyrën e këtij njeriu, kam të drejtë ta besoj edhe këngën e tij patjetër. Shfletoj një e nga një vargjet e ndër të poezive të tij dhe befasi ndihem i ngarkuar me klithma dhe vaje nënash, me hije të tejdukshme baballarësh, gjyshërish dhe gjyshesh të vrarë barbarisht nga i pabesi, përjetoi net Shën Bartolemeu dhe Guernikash të përgjakshme.

Janë momente specifike kur autori kthehet në peng kujtimesh dhe nuk mund ta mbajë dot vetveten. Është kjo arsyeja pse koha e leximit të poezive të Hekuranit të krijon një klimë dhe ndjesi të veçantë. Shoqëruar nga ngjyrimet dhe magjia e fjalës së bukur, sado i pandjeshëm të jetë, lexuesi i kësaj poezie sikur e përjeton dhe e prek më mirë të dukshmen dhe misterin e saj, aq më shumë në këto kohë të vështira depresioni dhe vakumi të stërzgatur shpirtëror, kur e bukura dhe të tjera kategori estetike, si ajo nëse do të përdornim një krahasim alternativ të G. Markesit: kanë nisur të udhëtojnë me vagonin e fundit të trenit të kohës.

Është një shumësi gjendjesh shpirtërore dhe realitetesh që të afrojnë me bujari copëza qëndrese dhe shpirt kundërshtie ndaj gjendjeve depressive, të arealit ku jeton heroi. Materializimi i saj në këtë lloj poezie shfaqet në mënyra dhe forma të



ndryshme, që nga ironia e thellë kafkiane, sarkazma e hollë e zheromjane, e deri tek dimensionin e klithmës, shohim të ngjizura bashkë njëherësh disa gjendje trishtim, zhgënjim, rebelim. Pikërisht, brenda këtyre gjendjeve e vizaton portretin e tij të shqetësuar edhe poeti. Rendja drejt thelbit dhe jo sipërfaqes, ju jep atyre një qartësim dhe peshë specifike të dukshme. Autori i përngjan një lajmëtarit në shumë raste, i cili mbasi ka vrapsuar dhe i ka grahur kalit nga sheshi i betejës, mbasi ka duruar shigjetat e helmatisura të pseudomiqve dhe pseudopolitikanëve në shpinë dhe kraharor, si mbetet gjë tjetër veç të shpallë kumtin e tij me një të folur të shpejtë por të përmbledhur qartë: "Për mustaqe rrezesh do ta kap këtë diell /E do ta përplas për tokë". Pse ndodh ky rebelim i drejtë në psikikën dhe sjeljen e poetit? Çështje kjo dalje e menjëhershme e tij nga vetvetja?

Përgjigja është e thjeshtë. Njerëzit e botës kanë ftohtë nën një diell që fshihet. Pushtetet në atdheun e tij ua kanë dimëruar jetën dhe i kanë lënë pa shpresë ata. Atëherë poetit si mbetet gjë tjetër, veçse të kalojë nga zhgënjimi, në mosbindje. Vini re se sa bukur e motivon autori këtë lloj veprimi: Sepse njerëzit e mi kanë ftohtë. Po kështu ngjet edhe në poezinë tjetër, "Të enjten". Ndërrimi i vendit me Krishtin, krahas gjetjes interesante, përbëjnë edhe një shkak më shumë për autorin, për të

të them se poezitë e këtij autori, më shumë se prej fjalësh, janë lot i fshehtë në faqet e ashpra të një biri të burrëruar nga dhimbja dhe pritja.

Dhe është aq e madhe kjo ndjenjë, sa çdo poezi e tij kushtuar kësaj teme më kujton dyvargëshin e njohur të Himenesi kur thotë: Ai qielli i rrokullisur, është hija ime. Nisur nga intensiteti i lëvizjeve dhe densiteti pohimeve të këtij libri, autori është në një garë të heshtur me kohën për të thënë sa më shumë të vërteta. Por në këtë këndvështrim, poezitë e tij, përveç "Poemes së gurit" dhe të ndonjë tjetre, janë koncize, dhe të kursyera në fjalë, si të jenë shkruar në ecje e sipër, apo në një moment të shkurtër pushimi mbi një pllakë guri kufiri. Afërsia e tij me aromën e vendlindjes e mban përherë të karikuar dialogun e tij me të.

Në vëllimin e tretë me poezi vëmë re përdorimin efikas të simbolikës. Kjo është shenjë pjekurie, por edhe nevojë e poezisë së tij për të gjetur sa më shumë elemente dhe mundësi shprehje për gjuhën e tij poetike. Kështu, etimologjia e rrënjëve, e themeleve dhe e gurit, s'janë gjë tjetër, veçse një kuptim epik etnosi dhe pavdekshmërie mbi të cilat ai vendos nostalgjinë e së shkuarës, si dhe parashikimet e së ardhmes.

Vargu i shkathët dhe metaforik, i ngarkuar fund e krye me imazhe dhe përjetime, është i aftë të përcjellë ide dhe mesazhe të fuqishme. Poeti e ka orientuar veten tek poetët e lidhur ngushtë me bashkëkohësinë dhe faktet e ditës. Duke pasur një sensibilitet të lindur, ai e ka të pamundur të fshijë vragat dhe gjurmët e tyre nga vetja. Në këtë mënyrë vargu i tij bëhet edhe një lloj tabloidi me vlera të larta përgjithësuese. Në poezitë "Bisedë me gurët", "Bukë me Hënë", ndërrimi i vendit me Krishtin, fuqia abstraguese dhe thellësia e mendimit arrijnë majat.

Poeti i përzgjedh me kujdes subjektet dhe heronjtë e tij lirik dhe arrin të shpërfaq me anë të tyre një pjesë të mirë të unit të tij jetësor. Pikturat poetike të Nazusë, babait, nënës apo ullinjve të vendlindjes, e ndihmojnë atë për ta shpërfaqur me me forcë idenë e trashëgimisë. Jo me kot shumë gjurmë dhe reminishenca të jetës së tyre, ai i ka gdhendur si me daltë ne relievet e kujtesës së tij. Janë vargje ku thjeshtësia dhe thellësia ecin në të njëjtë binarë. Poezitë e Hekuranit të lënë gjurmë në kujtesë dhe nuk harrohen lehtë. Kjo, jo për densitetin e figurave dhe elementëve të ndryshëm artistik, sesa të frymëmarrjes së fuqishme të tij, mpleksjes së të vërtetave artistike me ato jetësore, si dhe të një ankthi të përhershëm që e shoqëron atë. Janë pikërisht këto që e joshin dhe tërheqin natyrshëm lexuesin, duke e ngarkuar njëherësh edhe me emcione. Të njëjtat mesazhe arrin të përcjellë ky poet edhe në kolonën e tretë të "Aromës së jetës". Janë krijime të ndjera kushtuar motrës, mbesës, gruas, djalit dhe vajzës së bukur çame me fustan të bardhë, si të qëndisura me fije mëndafshi.

Edhe këtu autori të befason me lojën e pastër të ndjenjave dhe abstragimit, edhe këtu koncepti i lirisë dhe lartësismit të ndjenjave sentimentale, mbetet qëllim dhe kredo e përhershme. Nga libri në libër profili i tij poetik po bëhet më i plotë dhe më i veçantë, ashtu siç është ai vetë në jetën e tij të përditshme. Hekurani është një zë që rreket ta thotë gjithçka jo me zë të zakonshëm apo të diktuar nga të tjerët, por nga lartësia e fronit ku e ka ngjitur fjalën ai, shoqëruar me fëshfërimin e një dege ulliri, apo një tufë manxurani çamërie, me të cilën ajo bëhet më e bukur, më sensuale, dhe njëherësh më njerëzore.

Në shiritin e kohës

# DE RADA: MIDIS POEZISË DHE MATEMATIKËS

E vërteta është se në fillimet e tij De Rada nuk u shqua në asgjë. Hiç fare! Madje, në fund të vitit të parë në kolegji (pasi ngeli në klasë), Mikel Belushi, drejtori i Shën Adrianit e këshilloi të atin ta hiqte fare nga shkolla dhe ta mbante në shtëpi, të merrej me punët e bujqësisë

Dashnor KOKONOZI

Në dosjet e shumta të J. de Radës në Arkivin e Shtetit, që i shfletojta në fillim të viteve '80 ndërsa shkruaja romanin "Shtrati i Prokusit", më ranë në sy disa formula matematike në anë të dorëshkrimeve të tij.

Askush nuk qe marrë ndonjëherë me to. Kështu ndodhi që njoha një pasion dhe talent krejt të pazakonshëm të poetit të Makjes.

E vërteta është se në fillimet e tij De Rada nuk u shqua në asgjë. Hiç fare! Madje, në fund të vitit të parë në kolegji (pasi ngeli në klasë), Mikel Belushi, drejtori i Shën Adrianit e këshilloi të atin ta hiqte fare nga shkolla dhe ta mbante në shtëpi, të merrej me punët e bujqësisë.

I ati kërkoi edhe një vit provë, që të bindej për paaftësinë e të birit. Pikërisht vitin që përsëriti, De Rada pati ecuri mjaft të mirë dhe në përfundim të Kolegjit cilësohej si krenaria e tij. Drejtori, ai që deshte ta çonte të ruante delet, e mbante gjithnjë pranë vetes.

Së pari të bie në sy kujtesa dhe aftësia e tij për të kryer veprime të ndërlikuara krejt përmendesh. Bashkëkohësit, thonë se poeti ynë i ardhshëm gjatë viteve të shkollës ishte në gjendje të shumëzonte përmendesh edhe numra natyralë prej shtatëmbëdhjetë shifrash dhe të nxirrte saktësisht shumën e tyre prej disa milionësh.

Të dhëna të tjera më tregonin se ai kishte fuqi kujtuese ende më fenomenale për veprime mjaft më të ndërlikuara, siç do të shohim.

Këto zhvillime nuk mund të kuptohen të shkëputura nga ajo vatrë dijeshe si ishte seminari i Shën Adrianit. Ndryshe nga shumë shkolla tradicionale të kohës, ku mësimdhënia e matematikës përqendrohej në njohuritë që jepnin kryesisht matematikanët e lashtësisë (sot nuk e kujtoj nga e kam nxjerre këtë përfundim), në Shën Adrian futeshin në programet shkollore mjaft prej koncepteve matematikore moderne që kishin marrë zhvillim të madh, veçanërisht me punimet e Gausit.

Tamam në ato vite De Radës i lindi pasioni i fuqishëm për matematikën, që siç thotë vetë ishte "jo më pak i zjarrtë se ai për letërsinë". Dhe pati mëdyshje të fortë për të zgjedhur



midis poetit e matematikanit.

Me sa del nga shënimet e tij autobiografike, dashurinë për matematikën atij do t'ia ketë ngjallur profesor Gaetano Çerri nga Martur-

no, i cili kishte dhënë lëndën e matematikës në Institutin Nunciato të Napolit. Duke qenë i ushqyer me idetë e Revolucionit Frëng dhe madje si pjesëmarrës në Revolucionin e

a - vitit 1821 (i cili pati si forcë lëvizëse organizatën konspirative të karbonarëve), që dështoi në gjak, Çerri u detyrua t'ia mbathe nga kryeqyteti i Mbretërisë së dytë Sicilive dhe të gjejë strehim në Kalabri, ku jepte mësim në Shën Adrian.

Si mësimdhënës pasionant, ai mbante lidhje me matematikanët më në zë të kohës. Madje në disa raste ua merrte që në dorëshkrim studimet të cilat ua paraqiste nxënësve të tij të Shën Adrianit.

Në një rast, pas gjeometrisë plane të Euklidit dhe gjeometrisë së trupave të ngurtë, ai u shpjegoi nxënësve të tij leksionet konike të Karavelit (mbase duhet të jetë fjala për leksionet sferike të Vito Caravelli-t), që e kishte pasur mik, siç thuhet.

Nxënësit hasnin vështirësi në të kuptuarit e tyre, sepse nuk kishin njohuri të mëparshme për teorinë e tij.

Për këtë ngjarje De Rada shkruan: "Në nëntor 1832 profesor Çerri thuajse i dëshpëruar më thirri në dërrasë të zezë dhe pasi e shpjegoi lëndën në mënyrë të shkoqur, si mjeshtër që ishte, kërkoi që ta përsërisja edhe unë. Unë e përsërita por me disa pasaktësi të vogla. Këtë pastaj e hodha në të pastër në sallën e studimit dhe ua kalova shokëve për ta mësuar".

Është tamam kjo periudhë kur ai vazhdon ta studiojë në mënyrë më të ethshme matematikën dhe nuk ngurron të mbushë anët e fletoreve të tij me figura gjeometrike dhe formula matematike. Këtu përmendim se ai arriti kulme të tilla sa që mund të nxirrte përmendesh rrënjën katrore të një numri me njëzet e katër shifra, numër ky që po të shkruhet, i bie të jetë prej disa miliardësh. Një rast i tillë mbase nuk është unik në botë (nuk kam bërë asnjë kërkim), por ama mbetet tejet i rrallë.

Biografi bashkëkohësi i de Radës, M. Markiano (që ishte edhe kushëri i tij), përmend dy tre raste të tilla, gjë që provon se ai kishte me të vërtetë talent të rallë në këtë fushë. Thamë në fillim se De Rada dikur ka ndërjer mëdyshje për të zgjedhur midis matematikës dhe poezisë. Por mbase "konflikti" do të ketë qenë vetëm në dukje. Nuk janë të rrallë ata që shohim mjaft poezi të matematika.

## Veprimtarë të shquar

### KONTRIBUTI I NDRE MJEDJES NË LETËRSINË PËR FËMIJË

Ndre Mjedja së bashku me të vëllanë, Lazër Mjedjen, kryepeshkop i Shkodrës, krijuan Shoqërinë letrare "Agimi". Ajo kishte alfabetin e vet, me të cilin u shtypën edhe disa tekste shkollore

Xhahid BUSHATI

Ndre Mjedja: klerik dhe poet. Veprimtar i shquar i shkollës dhe i Gjuhës shqipe. Duke gërmuar në jetën e tij dhe atë letrare, didaktike e gjuhësore, më sojmë se, në vitin 1901, Ndre Mjedja së bashku me të vëllanë, Lazër Mjedjen, kryepeshkop i Shkodrës, krijuan Shoqërinë letrare "Agimi". Ajo kishte alfabetin e vet, me të cilin u shtypën edhe disa tekste shkollore. Ndër to, me rëndësi në fushën e letërsisë për fëmijë, përmendim: - "Këndime për shkollat e para të Shqypnisë" (pjesa e parë, Abetare, Vjenë, 1904); - "Këndime për shkollat e para të Shqypnisë" (pjesa e dytë, Vjenë, 1904); - "Këndime për shkollat e para të Shqypnisë" (pjesa e tretë, Vjenë, 1906). Këto tekste në vitet 1910 - 1911 u ribotuan të redaktuara e të transkriptuara në Alfabetin e Manastirit dhe u ribotuan disa herë (botimi i katër i tyre është bërë

në vitet 1926 - 1927) dhe shërbyen në shkollat tona deri në vitet 1930. Patën një përhapje të gjerë në të gjithë Shqipërinë: Shkodër, Prizren, Shkup, Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Filat etj. Në hartimin e tyre, hartim i cili u mbështet kryesisht në librat shkollorë austriakë, Mjedja bashkëpunoi me shkrimtarin Anton Xanoni. (Sipas shënimeve të studiuesit Prof. as. Dr. Astrit Bishqemi). Gjithashtu mendohet se "i gjithë procesi i hartimit të librit "Këndime" (pjesa e tretë, si tekst u mbulua vetëm nga një dorë, ajo e Xanonit). Ndërsa "Libri i parë dhe ai i dytë i Këndimeve" janë mbuluar nga dora e Ndre Mjedës (Mjedjes, shënimi im Xh. B.) [...] Mund të thuhet që Mjeda (Mjedja) të ketë bërë ndonjë redaktim të librit që kishte ndërhyrë Xanoni. [...] Një gjë mund të thuhet me saktësi, se dorëshkrimet e transkriptuara të tre librave të "Këndimit" u bënë nga dora e Mjedës (Mjedjes)... "

(Mentor Quku "Mjeda 3, Alfabeti, ILAR, Tiranë 2007, f. 405 - 406).

Në librat e vet (Këndimi I dhe II) Mjedja ka futur jo vetëm krijime personale në prozë e poezi, por edhe autorë të tjerë, shqiptarë e të huaj.

Në krijimtarinë poetike të Mjedjes kanë një vend të rëndësishëm edhe fabulat e tij. Ndonëse numri i tyre është i vogël, rreth 15-të; tharmin ato e marrin nga gurrat e La Fontenit dhe Ezopit, nga thesari ynë popullor, por, sigurisht, ndryshojnë shumë pre tyre. (Në ndihmë shënimet e Dr. Veli Veliut, Fabula shqiptare e periudhës së Rilindjes, Shkup, 1993).


Shumë nga krijimet poetike të Mjedjes, që u shkruan posaçërisht për fëmijë, si dhe disa nga ato që u shkruan për të rritur, u përfshinë në tekstet e leximeve letrare të nxënësve për dhjetëra vjet si: "Gjuha shqipe", "Vaji i Bylbylit", etj.; u përmblodhën në vëllimet: - "Guxo" (vjersha), Sh.

B. "Naim Frashëri", Tiranë 1953 (ku disa vjersha i janë adresuar gabimisht Mjedjes, pasi janë të Xanonit (si: "Erdhi ujku", "Djali e Balta", "Rrena", "Dhëlpna e bretkoca", "Filxhani i kafes", "Gruni dhe egjra", "Luani", "Thnegla e Pëllumbi", "Mini"... etj.

- "Agimi" (kallëzime), Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë, 1962 (me bashkautor Anton Xanoni); - "Vjersha për të vegjël", Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë 1967; - "Përmbledhje vjershash për fëmijë (lektyrë shkollore, 5), Libri Shkollor, Prishtinë 1972; Shkup 1989; - "Poezi të zgjedhura për fëmijë", Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë 1975; - "Përmbledhje vjershash për fëmijë" (lektyrë shkollore 3), NASHA KNIGA, Shkup 1984, 1988, 1989; - "Zambakët" (vjersha, gjëgjëza, fjalë ari), ARGETA LMG, Tiranë, 2000; - "Dimri dhe plaku" (vjersha të zgjedhura), DRIER, Tiranë 2002.

# TAKIMI ME MID'HAT FRASHËRIN

Që disa vjet më parë kisha dëgjuar emrin e Lumo Skëndos, emrin e librit "Hi dhe shpuzë", që kishte botuar në fillimin e shekullit tonë, pastaj edhe nga babai im, që e kishte mik dhe që ishte pajtuar në revistën "Dituria" që botonte në Tiranë në vitet tridhjetë



## Vedat KOKONA

Në Tiranën e viteve tridhjetë, që kishte nja tridhjetëmijë banorë, kur shkonin e nuk shkonin nja katër karroca dhe ndonjë veturë në sheshin e bashkisë, kur dilnin vetëm dygazeta të përditshme dhe një revistë në javë, kishte një librarë, i zoti i së cilës ishte Mid'hat Frashëri, alias, Lumo Skëndo, bir i Abdylit dhe nip i Samiut dhe i Naimit. Kur mendoj se sot, në Tiranën me gjysmë milion e ca banorë, të mijërave veturave, që paradojnë në karuselin e sheshit "Skënderbej", ku botohen me dhjetëra gazeta e revista në ditë, madje edhe pornoje, dhe se nuk ka

një librarë si ajo e Lumo Skëndos më shumë se gjysmë shekulli më parë, më hipën një valë hidhërimi që s'di si ta përcaktoj.

Ishte një librarë e bukur, së cilës s'i ka mbetur as gjurma më e vogël; jo vetëm e asaj të parështeviteve '33, por as asaj që ishte në RrugënMbretnore, pranë Bela Venecias, që më vonë u quajt Rruga e Barrikadave dhe që sot dhe asaj i ka humbur vula. Sipas traditës së vendit tonë, çdo gjë e bukur prishet dhe vendin e saj e zë e shëmtuara. Që disa vjet më parë kisha dëgjuar emrin e Lumo Skëndos, emrin e librit "Hi dhe shpuzë", që kishte botuar në fillimin e shekullit tonë, pastaj edhe nga babai im, që e

kishte mik dhe që ishte pajtuar në revistën "Dituria" që botonte në Tiranë në vitet tridhjetë. Nuk e kisha parë kurrë në kafenetë Bela Venecia dhe Kursal të kryeqytetit, siç shihja qeveritarët dhe intelektualët e asaj kohe.

Lumo Skëndon mund ta gjeje vetëm në librarinë "Lumo Skëndo". Iu luta babait të më shpinte një ditë tek ai. Më shpuri. E gjetëm ulur përpara një tryeze të gjatë katërkëndëshe. Ajo që më ra në sy, posa e pashë, ishte jaka e ngrirë e kollarisur, me dy cepa të ngritura siç e mbanin ata të shekullit XIX, kapaku i kollarisur i mëngës së këmishës që dilte nga xhaketat e kostumit krem shantung e që binte menjëherë në sy nga pastërtia dhe

pastaj ajo fytyrë që s'ishte si fytyra të tjera. Është e vërtetë se s'ka fytyrë të jetë si një tjetër, ashtu siç nuk ka edhe shenja gishtash që të jenë identike, por, në përgjithësi, të gjitha fytyrat e njerëzve janë njësoj në vështrim të parë, të shpëlarë, pa kolorit. Një fytyrë ndryshe nga të tjerat është ajo që godet menjëherë me vështrimin si një rreze dielli. Ajo që më bëri përshtypje në fytyrën e thatë, ishte shkëlqimi i syve. Thashë se ky njeri ishte ndryshe nga ata që kisha njohur deri atëherë, me përjashtim, sigurisht, të babait tim. Ai sikur u gëzua – apo ashtu m'u duk mua – kur mësoi se studioja në Liceun e Korçës. Që atë ditë, sa kohë isha në Tiranë gjatë kohës së pushimeve të verës, do veja shpesh në librarinë e tij. Një ditë iu luta t'i bëja vizitë në shtëpi, se kisha dëgjuar që kishte një bibliotekë shumë të pasur. Më ftoi mëgjithë zemër. Vajta.

Më duket sikur e kam para syve edhe sot e kësaj dite pas gjashtëdhjetë vjetëve. Ishte një nga ato shtëpitë e vjetra tiranase, me dy kate e me oborr të madh, në rrugën e Tenis Klubit. Kati i parë ku qëndruam, përbëhej nga një salloni i madh, muret e të cilit ishin mbuluar me libra. U ulëm në dy karrige të vjetra përpara një tryeze të vogël vezake, ku ishin vendosur një filxhan-kafeje me pjatë dhe një cigarishte. E dija që s'e pinte duhanin dhe ajo cigarishtja më tërhoqi vëmendjen.

Po shikon cigarishten?

-Si urdhëron, i thashë, me një zë pak të druajtur. Ju s'e pini duhanin?

-Kjo cigarishte dhe ky filxhan kafeje janë të Naimit. M'u duk sikur isha në ëndërr. Kisha përpara meje cigarishten dhe filxhanin e kafesë të Naimit dhe, pranë meje, ja, këtu, nipin e Naimit, Mid'hat Frashërin! A kishte gjë më të bukur. Më bëri çaj, solli edhe kutinë e vogël me peta sheqeri.

-Sa peta?

-Tre.

-Jo, bir, çaji pihet me pak sheqer. Një petë e ke mjaft.

I kundërshtoj Lumo Skëndos? Kisha dëgjuar se ashtu e pinin dhe anglezët.

Jo me një petë, po edhe pa sheqer fare e pija me ëndje atë çaj nga dora e tij!

-Mid'hat bej, pse nuk shkruani një monografi më të gjatë se ajo që keni shkruar për Naimin, sepse, përveç jush, s'ka se kush ta shkruajë?

Mirë i thashë, më duket. Ç'mirëzeza! Se mos kishte nevojë ai për mendimin tim. Nuk më dha përgjigje. E kuptova që kisha nderur jashtë jorganit këmbët që m'u bënë akull, kisha lëshuar një notë të rreme në simfoninë e asaj pasdrekeje të bukur. U tregua i duruar me mua edhe i sjellshëm. Një ditë më fali një libër, që i kishte pëlqyer shumë, "Un jardin sur l'Orente" (një kopsht në Orontë) të Moris Baresit, për të cilin më foli me pasion, sidomos për prozën e magjishme. Iu zotova se, me që i kishte pëlqyer, do ta përktheja. Më vështrroi me një buzëqeshje të lehtë stërpikur me ironi: "Në arrifsh dot", sikur donte të thoshte ajo buzëqeshje. Isha duke shkruar aso kohe disa poezi lirik edhe, me guximin e të riut, iu luta të mëshkruante një parathënie. Prisja dhe isha i sigurt se do të merrja një përgjigje mohuese. Si u mendua pak, më tha:

-Kur e do?

M'u duk sikur isha bërë me fletë!

-Kur të doni ju, Mid'hatbej!

Kaloi java dhe parathënia e kisha në dorë. Në dorë! Përmbledhja e parë e vjershave të mia "Dritë dhe hije" me parathënie e Lumo Skëndos! Mrekulli! Fluturova te Luarasi! Me këtë kanik po nisesha për në dasmën e letërsisë.


# ARTISTI DHE PËRVOJA

Cikli i famshëm i Beethoven-it prej 32 sonatash, më i miri i këtij lloji në historinë e muzikës, është në të njëjtën kohë një literaturë koncertale pedagogjike për nxënës të rinj dhe një vepër për pianistët më të formuar

Alija IZETBEGOVIQ

Meqë nuk ka evolucion në jetën e artit, nuk ka as në jetën e artistit. Çdo artist, që në kryeherë, nis të punojë sikur të mos ketë krijuar asnjë para tij. E thjeshtë: ai nuk shfrytëzon përvojën e tjetrit, por vetëm të tijën. Shfrytëzimi i përvojës së tjetrit, vazhdimësia e përvojës dhe akumulimi i saj është kusht dhe premisë për shkencën. Shfrytëzimi i përvojës së tjetrit në art është imitim, përsëritje, akademizëm, pra vdekje e artit. Picasso pikturoi për shtatëdhjetë vite me radhë, duke kaluar nëpër periudhën rozë dhe blu, në atë të kubizmit, të kubizmit analitik, njëfarë surrealizmi, përvoja si qeramist dhe skulptor e shumëçka që nuk mund të përkufizohet, por në këtë mes nuk ka asnjë evolim, asnjë lloj zhvillimi nga një nivel i dobët drejt një niveli më të mirë, nga më pak e përkryera kah më e përkryera. Vetë kultura si tërësi, si e tillë, është vetëm një dramë gjurmimi dhe kërkimi pa ndërprerje. Në raport me këtë karakter krijues të artit, jashtë përvojës (ose jashtë-historik), thjesht njerëzor, qëndrojnë edhe disa fakte të tjera shumë kuptimplota. Fjala vjen, ka shkencë për të rritur dhe shkencë për fëmijë. Njohja e shkencës, pastaj riprodhimi i saj, shfrytëzimi i dhe zbatimi i përfundimeve për praktikën, varet – përveç të tjerave – nga arsimimi, nga moshja, nga përvoja. Mirëpo nuk ka muzikë për të rritur dhe muzikë për fëmijë. Testet e bëra me ekzekutimin e veprave të Bach-ut, Mozart-it, Beethoven-it, Debussy-së dhe

Chopin-it dëshmuar se fëmijët e kuptojnë ose nuk e kuptojnë muzikën serioze njësoj siç ndodh me të rriturit. Cikli i famshëm i Beethoven-it prej 32 sonatash, më i miri i këtij lloji në historinë e muzikës, është në të njëjtën kohë një literaturë koncertale pedagogjike për nxënës të rinj dhe një vepër për pianistët më të formuar. Picasso pikturoi në moshën dy-vjeçare, në një moshë që akoma nuk fliste. Ovidi nisi të fliste me heksametra në kohën kur fëmijët e tjerë fillonin të artikulonin. Mozart-i organizonte koncerte në moshën gjashtë-vjeçare. Arti nuk është dije, pavarësisht se është njohje, por jo një njohje me mendje dhe me arsimim, porse me zemër, me dashuri dhe me thjeshtësinë e shpirtit. "Kur fshatari i kryen punët e zakonshme, merr një copë dru dhe bën skulpturë. Për këtë gjë s'i duhen katër apo pesë vite akademi. Dua të them vetëm se arti është i afërt për të gjithë, se nuk kërkohet ndonjë talent i veçantë, as shkollim. Çdokush është artist". (Jean Dubuffet) Kjo na kujton Tolstoin dhe shkollën e tij të Jasna Polianës, kur shqyrtonte ekskluzivisht me fëmijë të vërtetat më të thella religjioze dhe etike. Njohja e artit, e religjionit dhe e etikës nuk është intelektuale dhe logjike, por e brendshme. Këtu nuk rri përkundraill mendja ndaj mendjes, por zemra dhe shpirti ndaj një zemre dhe shpirti tjetër të njëjtë. Faktet e ekspozuara rrënojnë botëkuptimet tona tradicionale për "zhvillimin" e kulturës njerëzore. Kultura s'ka histori. Njeriu është konstantja e zhvillimit botëror.



## Fjala e filozofit

# SHPREHI DHE VËMENDJE

Gjithë vëmendja duhet të derdhet në shprehje, nëse ajo nuk duhet të hedhë në erë njeriun, gjithë shprehjet duhet të shkatërrohen nga vëmendja, nëse ato nuk duhet ta paralizojnë njeriun

Walter BENJAMIN

Në krye të të gjitha vetive, thoshte Gëte-ja, qëndron mendja. Megjithatë, këtë vend të parë ajo e ndan me shprehjen e cila, këtë klasifikim, e diskuton që prej ditës së parë. Gjithë vëmendja duhet të derdhet në shprehje, nëse ajo nuk duhet të hedhë në erë njeriun, gjithë shprehjet duhet të shkatërrohen nga vëmendja, nëse ato nuk duhet ta paralizojnë njeriun. Pikasja dhe shprehja, motivimi dhe çmotivimi janë malet dhe luginat e dallgëzimeve në detin e shpirtit. Por ky det ka gjithashtu bunacat e veta. Që njëra prej tyre, e cila përqendrohet krejtësisht mbi një mendim sfillitës, mbi një dhimbje dhe efektet e saj, e cila po ashtu mund të bjerë prë e zhurmës më të vogël, e një murmurime, e fluturimit të një insekti që nuk do ta pikaste mbase edhe veshi më i mprehtë, kjo është jashtë çdo dyshimi. Shpirti, thuhet, ndikohet më lehtë po të jetë i përqendruar. Por a nuk është

shprehja pikërisht ky përgjim, jo fundi, por më tepër shpalosja e skajme e vëmendjes, çasti kur ajo e lë të dalë nga prehri i saj? Zëzërima e mërmërima janë pragu, dhe shpirti e ka kapërcyer atë pa u vënë re. A thua se ai nuk do të kthehet më në botën e zakonshme, ai jeton tani në një të re, ku dhimbja është... e tij. Vëmendja e dhimbja janë plotësuese. Por edhe shprehja ka një plotësuese, prapun e së cilës ne e kapërcëjmë në gjumë. Sepse çfarë realizohet brenda nesh në gjumë, është një pikasje e re dhe e padëgjuar, e cila shpëputet nga prehri i shprehjes. Përjetimet e jetës së përditshme, ligjërimet bajate, precipitimet që na mbeten në sy, pulsimi i gjakut tonë, gjithë kjo e papikasur më përpara, përbën – të shtrembëruar e tepër të konturuar – lëndën e ëndrrës. Në ëndrra nuk ka habi dhe në dhimbje nuk ka harresë, sepse të dyja mbartin në vetvete të kundërtat e tyre, siç shtrihen bashkë në bunacë kreshta dhe lugu i dallgës.





Tregime: Alda Taçi SHPATA

# FITORE TË VOGLA

Nuk mund ta mohojë se ndikimi është i jashtëm, se gënjen në mënyrë mekanike, se të gjitha paraardhëset e saj kështu e drejtojnë të bëjë.

Emës i gënjehet.

Mbase dy-tre kohë pas kësaj gjendjeje do të ulet përballë dikujt dhe do i duhet të shpjegohet, por gjithsesi, flas për tani, Emës i gënjehet.

Është e çuditshme si iu shfaq vetja në gënjeshtërën e saj, si një trup plasteline me këmbë të shkurtra (si vetë gënjeshtër), e fshehur dhe e mbuluar me mendime gjithfarëlloj. Fshihet nga të gjithë, mbështillet me retorikë të kujdesshme dhe del para turmës duke hipur nëpër vende dhe sope të dekoruara për të mbuluar trishtimin dhe brishtësinë e dukshme.

Gënjeshtër, topthi prej plasteline, krijon pamje dhe imazhe të përsosura të shfaqjes së vlerave qytetare, ama, brenda zgavrës bosh të plastelinës ka spazma të forta makthi.

Ema me hire është zonja Gënjeshtër, i duhet të flasë shkoqur dhe të mbahet supzbuluar për bukuri, para ndërrimit të akteve dhe shoqërive.

Po të dështojë?!

Do e pranojë, pa u lerosur, duke e mirëpritur pa e humbur klasin, me shpikjen e saj pa frymëmarrje do të mundohet të mbijetojë.

Ema e di.

Nuk i shpëton dot fytyrës qortuese asnjë hetim i hollë i dy syve të vegjël popullorë. Ata depërtojnë dhe krijojnë plasaritje të imta të plastelinës. Ema ia di marifetet trajtës së saj dhe, shpejt, gjindjes ia ngec të shikuarin jashtë brendisë prej kukulle. Megjithatë, për pak sa nuk hoqi dorë. As mundet ta shpjegojë se si sinjeriteti i një mashtrimi të bie ne kokë. Madje, mendon se u terhoq e bindur në një hije të gatshme, për ta lënë të hapur një ndjesi të fshehur mu në thelbin e brendshëm të dëshirës.

Qëllimi, për ta zbuluar nga ku i buron gënjeshtërja Emës, na mashtron të gjithëve.

E vërteta është se asnjë të pagënjyer nuk ka, Ema na tregon kohët dhe vendet duke lëvizur vithet dhe supet për t'na çmendur.

## GËRSHËRËZA

Gërshtëza nxori kokën e saj të vogël nga shega ku ishte futur dhe rrëshqiti duke tundur trupin mbi dysheme. Nuk e di sa milimetra i zgjaste shikimi, por sapo hipte mbi diçka të lartë bënte një rrotullim njëqind e tetëdhjetë gradë dhe ndryshonte drejtimin. Çuditë, si u gjenda i përfshirë nga lëvizjet e saj të çoroditura?! Më hutoi ajo gjallesë myku e lagështire.

Për habinë time e pagëzova menjëherë me emrin Lara. Ky emër më doli tak-fak nga mendja. Sikur kishte pritur të shfaqej sapo të më dilte para një gërshtëze. E nxora nga ajo ditë që e pashë të shtrirë e të vdekur, të zverdhur e të rrethuar me një amzë dylli të sapo shkrirë.

Lara gërshtëz sikur i ndjeu sytë e mi mbi veten dhe i shpejtoi lëvizjet. Herë-herë rrokullisej nga nxitimi dhe i shihja një barkth pak të rrumbulla-



kosur e me ngjyrë më të çelur se pjesa e sipërme e trupit të saj. Nuk e mora vesh as vetë si u gjenda në gjunjë, i përfshirë i gjithi nga ato lëvizje të trembura. I dhashë pak trupit dhe lashë t'i binte një fashë drite dyshemesë ku lëvizte si në skenë Lara. Për një çast më dukej e sëmure dhe e lajthitur, sikur trupi i kërkonte të çlirohej nga demonët dhe përplaste bishtin e ndarë në mënyrë të njëjtë, në dy tehe gërshtëresh, nga të cilat ka marrë dhe emrin. Herë tjetër më dukej sikur brenda i vlonte pezmi për llojin e gjallesës që i kishte rënë për pjesë të ishte. Drejtoje dy antenat që kishte majë asaj grimce që mund të quhej kokë dhe gjuante ajrin e rraskapitur, sepse ato veprime të dëshpëruara as nuk mund të shquheshin.

Lara ma shtrëngonte dorën gjithmonë që ndiente se këmbët i bëheshin të ngurta, më shikonte në dritë të syrit dhe shquante brenda vështrimit tim. Zvarritej mes retinës duke rënkuar e me zor, aq sa në fund u dorëzua e shtrirë në një dërrasë, nga e cila buisën një re gërshtëzash pothuajse të gjitha njëjloj.

Më mbytën këto kujtime dhe iu vura pas me gishtin tregues gërshtëzës. Goja m'u mbush me lëng dhe rrahjet e zemrës m'u shtuan. Më hipi gjaku në kokë dhe i rashë me grusht dyshemesë aq fort, saqë dërrasa lëvizi nga vendi dhe krijoi një të çarë të errët. Gërshtëza shpëtoi nga grushti im dhe rrëshqiti në errësirën mes dërrasave. M'u ligështua aq shumë vështrimi, saqë rashë pa asnjë shpresë në dysheme. U lëshova si një thes i zbrazur, gjerba lotet që më dilnin nga sytë dhe hundët dhe iu dorëzova dhimbjes. U ndjeva i humbur e i dërrmuar, që atëherë kur e humba për së dyti Larën e di mirë se ç'është pikëllimi.

Për shumë kohë nuk ua hodha sytë shegëve, sepse nga to më binin për

pjesë gërshtërezat. Por edhe tani që kanë kaluar aq vite dhe kujtimet pothuajse më janë shuar, më hipën gjaku sapo shoh një gërshtëz. I qepem pas në çdo cep që futet, e shkel me këmbë ose e shtyp me gishta, aq sa bindem se kalbësia e saj nuk do ta qelbë më shumë botën. Për ta hequr nga çdo formë jete atë, e hedh në qypin e banjës, i urinoj sipër dhe e shkarkoj ujën disa herë rresht.

## E TANISHME PA ZË

Me shefat e mëhershëm nuk i dihet a ka qenë jeta më emocionuese se tani. Ky i riu është i çuditshëm.

Të gjithë janë në gjendje alarmi dhe presin urdhrin e të madhit. Ai vetë është, por nuk shfaqet. Të rinjtë binden. Nga pamja e jashtme nuk ka asgjë të qortueshme në qëndrimin e tyre. Xhaketat i kanë të hapura dhe këmishët e kopsitura, kanë vënë kollare të zeza, shndrisin nga eleganca dhe nuri. Kështu i do Ai. Dielli sapo ka feksur dhe majat e maleve shkëlqejnë për këdo që di ta hedhë shikimin mbi to. Ajri mëngjesit të ngop mushkëritë dhe flladi i lehtë u prek me merak fytyrat djelmohave.

Më duhet ta sajoj vetë historinë e emrit.

Djali, të cilin do ta përdor për të treguar akullimën e ngjarjes, nuk më lodh shumë që ta dalloj mes të rinjve. Ai jam unë.

Bulëzat e djersës mbi buzën time vezullojnë nga dielli, dhe po të duash t'i mbyllësh sytë e mos të shohësh asgjë, ndien si dihas mes të tjerëve. Sa herë që mundohem të shikoj veten, stërmundohem, duket sikur e kam pasion të vuaj. Unë e njoh, frika aq më bën, mbushem me frymë dhe më hov gjoksi nga dëshira e mekur. Dua ta zbuloj para të tjerëve e ta

ndëshkoj, kam mbledhur mllefina e të gjithëve.

Me siguri e mbani mend, që të gjithë kanë humbur zërin, ndër më të bukurin që mund të qe deri në të tanishmen, veçse për ta kapur jehonën e tij të duhet shumë mund, sakrificë e guxim. Atë e fsheha unë. Më urdhëroi shefi.

Njerëzit u lodhën duke e kërkuar, sytë e tyre kërkojnë të çmeritur dhe shenjën më të vogël për ta zënë gafil njeriun që ka grabitur gjuhën e të gjithë gjindjes.

Ndjesia e tmerrshme e humbjes i ka dërrmuar. Nuk guxojnë ta pranojnë si e kanë humbur atë që e kanë pasur. U ka shkuar mendja dhe më parë seç ndryshime ka mes njëri-tjetrit dhe sa e habitshme është që kjo pranohet qorrazi, pa ndërmjetësimin e askujt. Dyshimi se mund ta shtijë secili në dorë i tensionon të gjithë, ndaj për ta mbajtur ngjarjen në kontroll përgatiten, vishen e kollarisin për merak. Zëri humbur shkëlqen brenda një fyti dhe e mban vullnetin e të gjithëve të tendosur. Nga vendi i fshehtë i mendjes, aty ku ka mbetur pak kujtesë ndihet një kuje e mbytur. Ata si të pushtuar nga djajtë dridhen dhe përpëliten me mirësjellje, mynxyra ka përfshirë të madh e të vogël në të gjitha rangjet dhe në ato të lartat.

Po të hedhësh sytë mbi radhën e të rinjve, mbi kostumet dhe fytyrat e tyre, po të dish vërtetë të shohësh, do të këndellesh nga aftësia e tyre e të qenit të bukur të pazë. Të gjithë njerëzit janë shndërruar në prene time.

Unë e kam zërin, megjithëse është e habitshme si arrij t'i çorodisë të gjithë. Shikoj me veshë e dëgjoj me sy të gjitha poshtërsitë që bëhen rreth e rrotull meje, pa më dalë askund emri. Ekzaltohem duke admiruar perëndimin e diellit majë kreshtave dhe marr vëmendjen e shefit.

**DUKE TYMOSUR MESNATËN**

Iku e martja  
 Para pak minutash Antologji e zezë të Adem Gashit e rilexova  
 Nuk e di nëse i tymosa njëzet apo njëzet e pesë cigare  
 Gjatë ditës ku terri dhe drita ishin përzier  
 Tani për tani e shpërqendroj mesnatën me Marlboro Lights  
 Që t'mos më zë gjumi  
 T'mos më mundë dhembja  
 Teksa shohë të shtrirë plakun tim  
 Çfarë paradoksi  
 Teksa mantelbardhët shërojnë mushkëri  
 Pacientët ecin kundër rrymës së tyre  
 Thithin cigare njëra pas tjetrës  
 Të vetëdijshëm pa frikë  
 Deri atë ditë kur perdja e dhembjes do ua errësoj sytë  
 Do të shtrihen përdhe si një bisht cigareje  
 E shkelur me majën e këpucës plotë baltë

(8 mars 2023 - Prizren)

**BLASFEMI**

Shiu tashmë e ka pushtuar qiellin  
 Ka tre ditë stina po i lanë mëkatet

Diku në shkretëtirën e kozmosit  
 Dikush e ka vjedhur detin  
 Njelmësinë e tij e ka ëmbëlsuar

E ne që besojmë në përralla  
 I presim ditët e mira  
 Me duart e lidhura pas shpine

Shëndoshë me qenë se qon Zoti  
 Më thanë një pasdite prindërit e mi

I dëshpëruar me jetën  
 Më iku një blasfemi  
 Më mirë nuk po e them

(4 dhjetor 2022)

**KUJTIMET E FUNDIT**

Me shpirt u mundova t'ia jepja zemrën  
 A dalim vrapojmë pak o babë - i thashë  
 Buzëqeshi teksa pëshpëriti Ah! More biri im...  
 Dhe shau nëpër dhëmb  
 S'e di nëse më shau mua  
 Apo jetën që e kishte mashtruar me kurthet e saja  
 Edhe pse mendojmë si unë si Ai  
 Kurrë jetës nuk i kemi besuar  
 Për vdekjen më mirë të mos flasim

Kur u shtri në shtrat që tashmë i ishte ngjitur për trupi  
 Ia dhashë ngadalë një kokërr Therdor një Aldizem dhe një Carvaxyl  
 Dhe në fund Vitamin every day 2x1... ora ishte fiks dhjetë

Dola në oborr  
 Ndeza radion  
 Në nënkulmin e pusit tymosa tri cigare njëra pas tjetrës  
 Derisa mjegulla e shpirtit m'u bë se u kthjellua tërësisht

Lëshova muzikën e Ludovico Einaudi - Una mattina  
 Pastaj zbrita thellë në kujtimet e mia të bëra asht e lëkurë  
 U ula te hija e ftoit qava teksa nana bënte gati pite për drekë  
 Ndërkohë i shemba fshehurazi pesë gota raki të Suharekës  
 Shoqëruar me cicërimën e zogjve të verës  
 Që sapo kishin mbërritur në shpirtin e ylbër të stinës

Gjersa koha shkrihej si gjalpi në tigan  
 Babai filloi ta ndiente ngadalësimin e frymëmarrjes  
 Dera kishte pësuar plasaritje  
 Të trishtuar të humbur në mendime të ftohta  
 Shikonin me urrejtje mysafirin e zi i cili ishte bërë gati për sulm

Nën kulmin e kuq jeta që mbështjellë me një grusht vetmi  
 E cila sikur priste çastin e duhur për të eksploduar  
 Që t'na lëndoi e t'na vriste të gjithëve me trishtim e mërzë

**S'ËSHTË ÇUDI**

S'është çudi të zgjohesh i çmendur  
 Ta kapërcesh murin e arsyes  
 Duke i sharë një nga një pemët  
 Duke pshurrur afër derës së parlamentit  
 Gishtin e mesëm t'ia tregosh presidentit  
 Pa harruar t'i thuash... nanën...

S'është çudi të çuditesh me çudirat tona  
 Të tentosh të bësh vetëvrasje  
 Të përfundosh në psikiatri  
 Si prishës i rendit publik

Çudi s'është nëse të thërrasin në festë  
 Dhe përfundon i varur në litar

Çudi s'është nëse të ngrenë në qiell  
 Dhe sheh se je duke u rrokullisur si një mut sorre  
 Mbi kokën e ndonjë kalimtari të pafajshëm

Çudi s'është të zgjohesh me gishtin në gojë  
 Më të cilin pak më parë e kruaje bythën e bardhë

S'është çudi të biesh në dashuri  
 Me gruan e ministrit me urdhër të ministrit  
 Sepse karrigia duhet të blihet disi  
 Një herë... një votë mbështjellë me dashuri  
 Kurrë nuk është falas sa çudi

S'është çudi të të vidhet ëndrra  
 E të akuzohesh për plagjiaturë  
 Të përfundosh prapa grilave  
 E ta paguash lumturinë e tjetrit  
 Me vuajtjen tënde absurde

S'është çudi të vdesësh për atdhe  
 E të të shpallin tradhtar

Çudi s'është nëse luftë bën nëpër shtëpi publike  
 Dhe përfundon si president i një shteti appena natto

Çudi s'është t'ia kalosh pushimet në Durrës  
 Të lodrosh natën me zonjusha n'Beograd  
 Të vetëquhesh gjeneral pa i mbushur tetëmbëdhjetë vjet  
 T'ia biesh çiftelisë e të hash mish viçi  
 Të pish çaj Indie si qen i keq rrugësh  
 Të gërvallesh si kalë se je patriot...  
 Pa e shkrepur kurrë një plumb pushke  
 E të marrësh një rrogë si veteran lufte

S'është çudi të jesh i varfër në darkë  
 E të zgjohesh në mëngjes si pronar banke

Çudi s'është nëse tërë kohën vret e vjedh  
 Pastaj të thërrasin eja udhëhiqë këtë vend  
 Është çudi nëse sheh se dashuria ka lulëzuar  
 Mbi varret e atyre që u bënë ylber  
 Për rrugët e mbuluara me terr

Çudi do të ishte  
 Të ta presin litarin në qafë  
 E të ta japin një gotë me ujë

Çudi mbi çudira do të ishte  
 Ta takonim mbjellësin e ëndrrave  
 Që hedh farën në fushën e djerrë  
 Të tjerët kur të vijnë pas nesh  
 Ta korrin dashurinë e vërtetë

Sa do të doja të ndodhnin  
 Këto të fundit tri çudi

(23. IV. 2020, Itali)

### Mohsen Mohamed

## NJË NATË NË SHOQËRINË E SAJ ËSHTË MË E MIRË

O e ëmbla ime që mbështjell një lëmsh, dredhoje rrugën tënde rreth zemrës sime. Unë të kurorëzoi sovrane të saj. Gishtat tu janë nektar i ëmbël. Ti që e shndërron istikamin e dashurisë në fortesë dhe kupolën në qiell të pafund. Oh, sa flirtuese që më je, oh!

Sa e lezetshme je derisa pjek kahk, Egjiptian me rrënjë, me temperament dhe me të qeshura. Kam humbur rrugën për shkak të bukurisë sate. Vij duke çaluar deri te dera jote ama me qëndrim. Jam pelegrin, flas, këndoj dhe vallëzoi – valle orientale, samba, mazurka, ose dabka. Për çdo të dashuruar – je Mekë.

Nina Kossman

Oj, loçka ime, ti je Qabe unë sillem, kthehem, vrapoj, eci, dhe qëndroj – jam dervish, dhe zemra ime do si sufi derisa ti më tjerr si leshin. Lirshëm ndërsa afrohesh, unë kam frikë nga sytë e të huajve.

Mahmoud Darwish

Egjipti ynë i lartësuar në sytë e grave të reja. Egjiptianët, e adhurojnë këtë Egjipt dhe i përgjërohen. Nga fytyrat e vajzave të tij, mësojnë të lexojnë e të shkruajnë. Egjipti shfaqet në joshjen e tyre të nxirë dhe jehonës në sillgun e tyre. Një e qeshur e tyre krijon gëzim, ndërsa ti, sall me buzëqeshjen tënde, ma plas shpirtin.

Mahmoud Darwish

O e ëmbla ime, një organo kumbon në timbrin tënd. Qeshjen tënde e jep me dashuri. Heshnja jote është tunduese, e folura jote, mëkatare. Heshjtjet tuaja tingëllojnë si poezi në zemrën time, ndërsa fjalët tua më ngrohin. Erdhi mëngjesi dhe zemra ime nuk ka fjetur fare, sepse nata është më e mirë në praninë tënde

### Nina Kossman

## BESIMET E MIA TË VJETRA

Nina Kossman

Kur isha pesë vjeçe, besoja në komunizëm. Kur isha njëmbëdhjetë vjeçe, besoja në cionizëm. Kur isha nëntëmbëdhjetë vjeçe, i besoja njeriut. Kur isha njëzet e tri vjeçe, i besoja vdekjes. Kur isha tridhjetë vjeçe, i besoja vetes sime. Kur isha tridhjetë e nëntë vjeçe, i besoja kohës. E zhgënjyer me të gjitha këto, Tash unë besoj në diçka tjetër, Nuk do t’ju them se çfarë.

### Mahmoud Darwish

## LUFTA

Lufta do të përfundojë. Udhëheqësit do t’i shtrëngojnë duart njëri-tjetrit. Plaka do të vazhdojë të presë djalin e saj dëshmor. Ajo vajzë do të presë bashkëshortin e saj të dashur. Dhe ata fëmijë do të presin babanë e tyre heroik. Unë nuk e di kush e shiti atdheun tonë. Ama e pashë kush e pagoi çmimin.

### Lou REED

## SHTËPIA IME

Mahmoud Darwish

Imazhi i poetit në puhë Patat kanadeze fluturojnë mbi pemë Mjegulla butësisht varet mbi liqen Shtëpia ime është shumë e bukur gjatë natës Miku dhe mësuesi im zë dhomën e lirë Ai ka vdekur – në paqe më në fund Çifuti Endacak Miq të tjerë i kishin vënë gurë varrit të tij Ai ishte njeriu i parë i madh që kisha takuar ndonjëherë Silvia dhe unë nxorëm tabelën tonë Ouija Për të thirrur një shpirt – ai u ngrit në dhomë Ne ishim të lumtur dhe të mahnitur me atë që pamë Flakërues qëndronte emri krenar dhe mbretëror Delmore Delmore, më kanë munguar të gjitha mënyrat tua qesharake Më kanë munguar shakatë dhe gjërat e shkëlqyera që ke thënë Dedalusi im për Bloomin tënd, ishte një zgjuarsi kaq e përsosur Dhe të të gjej në shtëpinë time i bën gjërat perfekte Përnjëmend kam jetë me fat Shkrimi im, motoçikleta ime dhe gruaja ime Dhe mbi të gjitha, një frymë e pastër poezie Po jeton në këtë shtëpi prej guri dhe druri me mua Imazhi i poetit në puhë Patat kanadeze fluturojnë mbi pemë Mjegulla butësisht varet mbi liqen Shtëpia jonë është shumë e bukur gjatë natës

### Lewis Lipsitz

## DHJETË PARALAJMËRIME PËR MESHKUJ

Mahmoud Darwish

“Kini kujdes nga mashkulli që lavdëron femrat e emancipuara; ai po planifikon ta lë punën.” Erica Jong, “Shtatëmbëdhjetë paralajmërime në kërkim të një poezie feministe”

Mahmoud Darwish

Kini kujdes nga poetesha; ajo është duke pritur të jetë e befasuar nga një mjellmë.

Mahmoud Darwish

Kini kujdes nga gruaja me lapsa të mprehtë; ajo kujton se jeni shënim margjinal.

Mahmoud Darwish

Kini kujdes nga gruaja që vjen drejt teje; ajo kujton se është dritë në fund të tunelit.

Mahmoud Darwish

Kini kujdes nga gruaja që ju pranon ashtu siç jeni; ajo është e shterur.

Mahmoud Darwish

Kini kujdes nga gruaja që ka qejf të gatujë; ajo do t’ju detyrojë t’i rrëmoni të lënat.

Mahmoud Darwish

Kini kujdes nga gruaja që nuk ka qejf të gatujë; ajo do t’ju hajë të gjallë.

Mahmoud Darwish

Kini kujdes nga gruaja që nuk ka qejf të preket; ajo mban një listë të lëndimeve të vogla.

Mahmoud Darwish

Kini kujdes nga gruaja që ngre pesha; ajo ka për t’ju zhgënjyer.

Mahmoud Darwish

Kini kujdes nga gruaja e paemancipuar; ajo e di kur ta thërrasë avokatin e saj.

Mahmoud Darwish

Kini kujdes nga gruaja e emancipuar; ajo është vetë avokate.

### Mahmoud Darwish

## “JAM PËRLOT NDJENJA”

Mahmoud Darwish

Jam përplot ndjenja Lehtë mund të besoj Duhet të jem sentimental. Mirëpo kur përsiatem E shoh se çdo është në mendim, Bash asgjë s’kam ndier.

Mahmoud Darwish

Të gjithë ne të gjallët kaluam Një jetë duke e jetuar, Atë tjetrën, duke e menduar. Dhe të vetmen jetë që kemi Është e ndarë përmes Asaj të vërtetë dhe asaj të rreme.

Mahmoud Darwish

Ama cila është e vërtetë Dhe cila është e rreme Askush s’mund ta shpjegojë. Dhe derisa ne vazhdojmë të jetojmë, Jeta që kemi jetuar është ajo Që ka qenë e paracaktuar për t’u menduar.

Mahmoud Darwish

(1933)

Mahmoud Darwish

Mahmoud Darwish

Mahmoud Darwish

Mahmoud Darwish

### Faruk Šehić

## PAS KATAKLIZMËS QË DO TË VIJË NJË DITË

Mahmoud Darwish

Temat e tyre janë më të rëndësishme Ata shkruajnë në gjuhë të madhe Temat tona janë të parëndësishme Ne shkruajmë në një gjuhë të padukshme

Mahmoud Darwish

Gjithçka e tyre është më e madhe nga gjithçka jona Penis i tyre është më i madh, edhe vaginën e kanë më të madhe Edhe bombat e tyre janë më të mëdha, varret e tyre janë XXL Varret tona, përsëri, të gjitha janë të vockla,të padëgjueshme deri në pikën e dhimbjes

Mahmoud Darwish

Gjuhën e kemi sistem të ndërlikuar zërash me brirë Të vështirë për t’u shqiptuar, edhe temat i kemi të rënda, librat të rënda plumb Gjithçka e jona e parëndësishme, jemi hapësirë fantazie, arabeskë Gjithçka e tyre më e madhe, e jona gjithnjë e vocërr dhe më e vocërr

Mahmoud Darwish

Kurrë nuk do të bëhesh i famshëm si ata Nuk e ke emrin bombastik, i yti është bezdisës për vesh Ti nuk shkruan sipas diktatit të tregut as të epokës Çfarë janë idhujt e tyre për ta për ty janë polakët

Mahmoud Darwish

Me lojëra fjalësh jashtëzakonisht të rëndësishme hipsterësh Me finesë në gjuhë, ndërsa gjuha jonë çjerrë qiellin Ne shprehemi me vetëtima dhe bubullima Ne nuk jemi të aftë për mendime të rëndësishme filozofike

Mahmoud Darwish

Emri yt nuk është as River as Oqean Nuk ke vuajtje që është ikonike, dhe e përshtatshme Shpina jote e djegur nuk e ka parë ballinën e Tirne-it Edhe lufta është jote hiçasgjë, krejt ç’është e jotja është e paktë, një mostër e AND-së i nxen

Mahmoud Darwish

Betejat e tyre janë të mëdha Poetët e tyre dolën nga frymëzimi që ua ka dhënë zoti Mendimi, ideja, gjithçka mbufatet nga forca Aty ku ne kemi parë një vijë të thjeshtë, ata kanë parë labirinte

Mahmoud Darwish

Derisa ne ndanim para në delirin e epokave Qerasnim muzikantët e zjarrit flakërues dhe të pastrimit Ata i kursenin monedhat, i ruanin për brezat e ardhshtëm Për këtë arsye s’na nxen kund vendi vend, nomadë pa busull

Mahmoud Darwish

Na pret i njëjti fat, e njëjta fatkeqësi jofilnike Këngët tona janë më të mira se tuajat, të pagëzuara me gjak Singërisht, ngado që ia mbajmë, Një ditë ju do të na admironi si ne Homerin.


Mahmoud Darwish

2018.

*I përktheu: Fadil Bajraj*

# PIKTORI ETNOGRAFIK

(Fragment nga libri "Shqiptarët e Léon Gérôme")



## Luan RAMA

"... Në vitin 1861, në "Sallonin e Pikturës" të Nantes, e dy vite më pas në "Sallonin e Parisit", Gérôme ekspozoi tablonë e madhe Robi, (Le Prisonnier), 45x78 cm, ku duket një barkë e gjatë që shket mbi Nil, e drejtuar nga shqiptarë që mbartin një rob turk. Kjo tablo, është cilësuar nga kritika e kohës, si kryevepra e periudhës egjiptiane të Gérôme dhe sot ajo gjendet në Muzeun e Arteve të Bukura të Nantes, në veri të Francës. Në fakt, ai u detyrua të bëjë një kopje të kësaj tabloje, pasi Muzeu i Nantes refuzonte ta dërgonte në ekspozitat parisiene. I frymëzuar nga kjo tablo, poeti i madh francez i asaj kohe, José Heredia, shkroi një poezi me të njëjtën titull, Robi, dedikuar mikut të tij Gérôme, ku shkruante:

"Thirrjet tutje myezinët kanë reshtur  
Qielli i blertë në perëndim me një të  
purpur stoliset  
Krokodili zhytet dhe duke kërkuar baltën  
Ndërsa lumi i madh e i gjerë zhurmat e tij  
përgjum.

Ulur këmbëkryq si ata që pinë duhan  
Përkundur nga hashashi i habitshëm  
prijësi ëndërronte  
Ndërkohë që dy negër barkën lëvizin me  
forcë  
Lakuriq e të përkulur mbi rremat e saj.

Mbrapa i gëzuar dhe me talljen në buzë  
Duke i rënë tamburasë me një ritëm të  
cartur,  
Me sy të egër e të gjallë arnauti përkulet  
Pasi i lidhur në barkë, me gjakun që i rrjedh  
Një sheik plak me pamje të rëndë dhe të  
habitur  
Sheh minaret me maja që dridhen mbi  
Nilin e kulluar."

Shumë shkrimtarë e kritikë arti kanë  
shkruar rreth kësaj tabloje magjistrale të  
Gérôme, sa realiste e ekzotike dhe e punuar

Edhe pse Gérôme nuk e vizitoi asnjëherë Shqipërinë, arnautët nisin pushtojnë telajot e Gérôme, në funksionet e tyre më tipike, shpesh nëpër kafenet apo në rrugët e qytetit dhe në mbajtjen e rregullit në një shtet gjigand, kufijtë e të cilit, nuk dihet ku shkojnë. Përsëri në Kajro... Gérôme, është në kërkim të personazheve të reja. "Gérôme, - shkruante Théophile Gautier, - bëri pelegrinazhin që ëndërronte Th. Chasériau. Ai përjetoi Kajron, këtë kryeqytet të Orientit, këtë qytet të kalifëve, ku arti sarazen vezullonte plot shkëlqim, atëherë kur Perëndimi ende ishte zhytur në barbarinë e tij të ashpër. Ai përshkoi ato rrugë të përdredhura, ku anash ishin shtëpitë me kate që vështronin mbi to dhe ballkonet me kashtë të thurur. Arnautin me hundën dhe vështrimin e shqiponjës, e ndoqi deri te fellahu që s'e prishte gjakun përballë Sfinksit egjiptian, dhe atë turmë që vërshonte nën kërbac para kalit të beut, buzë deltës perëndimore e Nilit..." Piktura e kësaj periudhe e Gérôme, na shfaqet si një pikturë realiste dhe sigurisht me tone ekzotike, por në tërësi, personazhet e tij janë tepër realistë, duke krijuar kështu tipa interesantë me një dinamikë të jashtëzakonshme shprehëse. Padyshim që fustanella është një nga ornamentet më interesante të figurave të arnautëve, çka e gjejmë jo vetëm në pikturat e bashkëkohësve të Gérôme, apo dhe pas tij, por edhe në letërsinë e shkruar, siç e gjejmë më pas, edhe në kujtimet e shkrimtarit të madh Alexandre Dumas. Një ditë, kur Dumas përgatitej për të shkuar në një ballo me maska, që organizoheshin atëherë në sallonet parisiene, Amaury Duval, nxënësi i piktorit Ingres, të cilin e kishte njohur në ballot e Firmin-it, i kishte thënë, se mund të vishite një kostum arnauti. Kjo ide Dumas-ë

i kishte pëlqyer. "Amaury Duval vinte nga Greqia, - shkruante Dumas në librin e tij Kujtimet e mia, - ku kishte bërë pjesë në ekipin e artistëve që kishin dërguar në vendin e Perikliut, pas betejës së Navarinut dhe ku gjatë një balloje në Firmin, ai kishte ardhur i veshur si Palikar. Kjo veshje ishte mjaft në modë në atë kohë dhe të gjitha vajzat e pëlqenin këtë veshje. Ramë dakord se kostumi arnaut më shkante për mrekulli. Amaury e vizitoi atë. Ajo që ishte interesante te ky kostum, ishte turbani, i cili pasi rrotullohej dy-tre herë rreth kokës, kalonte nën gushë dhe pastaj lidhej në pikën e fillimit. Por duhej qepur kostumi, i cili dhe duhej qëndisur. Për të, u punua gjatë 15 ditëve. Kur erdhi dita e ballos, paradite, kostumi ishte gati. Në mesnatë hyra në sallonin e zonjës Lafond..."


I veshur me kostumin arnaut, sipër në velur të kuq dhe me fustanellën e bardhë si dëborë, me armët e argjendta që i shkëlqenin, ai dukej sikur vinte nga një botë ekzotike dhe e panjohur. "Me atë kostum imagjinoja se do të kisha një triumf të vërtetë... Ai s'kishte bërë as dhjetë hapa në atë sallon, kur zonjusha Malibran, i ishte afruar dhe i kishte thënë: "Zoti Dumas! Ju do të më mësoni sesi vihet ky turban. Këta djaj italianësh nuk dinë si të vishen. Do doja, së paku, të visheshin si ju! Nesër do të interpretoj Desdemonën"... Si dukej, asaj nuk i kishte pëlqyer se si ishte veshur partneri i saj, Otello. Kostumit shqiptar, Dumas i referohet disa herë në librin e tij Impressions de voyage de Paris à Sebastopol (Përshtypje udhëtimi nga Parisi në Sebastopol). "Jakobi më kishte shitur dy kostume, - shkruante ai. - Mora atë më të bukurin, kostumin shqiptar, me një cohë vjollce, me qëndisma argjendi. Për një çast hezitova, midis turbanit me stof të hollë e





të bardhë, që të mbështjell fytyrën, duke e kaluar nën mjekër dhe rasës së kuqe me një xhufkë mëndafshi që varej." Padyshim që, armët ishin jo vetëm zbulurimi më me vlerë i arnautit, por edhe lavdia e tij. Madje, ai e personifikonte veten përmes armëve të tij, çka e ndeshim në shumë nga tablotë e piktorëve francezë, të

shekullit XIX. Karnaku, që në gjuhën arabe do të thoshte "fshat i fortifikuar", ishte larg në Egjiptin e sipërm. Qyteza e Egjiptit, në veri të Tebës të vjetër, me në krye zotin Amon-Ré, gjatë dymijë vjetëve kishte strehuar faraonët e mëdhenj, që nga Sestre I e deri në epokën Ptolemike. Aty ishte dhe tempulli i madh i



Amon-it. E pra, pikërisht atje, arnautët kishin kafenetë e tyre, ku kalonin ditët e gjata e të pafund, ku luanin damë për të vrarë mërzinë dhe ku meditonin për familjet e tyre që kishin lënë larg në More, në Epir apo në viset e sipërme shqiptare... Vallë a do të ktheheshin? Atje në Egjipt ata ishin si zotër të atij vendi dhe mbaheshin me përkujdesje nga dinastia e Mehmet Ali Pashës. Atje ata kishin gjithçka. Qejfet ishin të pareshtura dhe "almée"-të ishin në duart e tyre. Mund t'i kishin në krahët e tyre si t'i donin dhe kur të donin, greke, armene, kirkize, egjiptiane..."

Të gjitha këto tablo kanë një atmosferë të jashtëzakonshme, çka u ka dhënë shkas kritikëve ta konsiderojnë Jean-Léon Gérôme si një "piktor etnografik", ku etnografia, lloji i figurës, kostumi, ornamentet, dekorat, marrin një rëndësi të rëndit të parë.

Maxime Du Camp shkruante se "kur ky artist synon të jetë i saktë, ai është më i saktë se askush tjetër, por për ta arritur këtë, duhet që ai ta ketë vështruar: ai ka imagjinatë të keqe, por një kujtesë shumë të mirë. Në kalim e sipër, ai ka pikasur e skicuar me një gëzim të madh tipat e Orientit. Arabi, shqiptari, turku, barabasi, siriani njihen menjëherë dhe në shprehitë e këtyre personazheve ai mbetet gjithnjë realist, i vërtetë. Në skenat historike si dhe në skenat orientale, zoti Gérôme kërkon para së gjithash të godasë publikun për nga vërtetësia.

Në librin Jean-Léon Gérôme, të botuar me rastin e ekspozitës retrospektive të këtij piktori, kritiku Dominique de Font-Réaulx, ndër të tjera shkruante: "Pa asnjë dyshim, ashtu si dhe bashkëkohësit e tij, Jean-Léon Gérôme ishte i ndjeshëm ndaj elegancës së kostumit të arnautëve, njëherësh luftarake dhe plot hire, në mënyrën e tyre të veshjes, me një xhakëtë të hedhur supeve dhe një fustanellë të bardhë e të gjerë, një përzierje kjo e violencës dhe e sensualitetit. Dhe sigurisht, ai është interesuar rreth këtij populli europian, por mysliman, një popull fqinj me grekët, por që i shërbenin perandorisë osmane, një përzierje pra, e Lindjes dhe e Perëndimit. Ky dualitet i këtyre personazheve, i ofronte Gérôme-it mundësi skenografike e pikturale. Para së gjithash, arnauti ishte për të një figure imagjinare, para se ai të ishte një figure reale. Motivi i kostumit e ka ngacmuar atë që para se të ndërmerre udhëtimin e tij në Egjipt, në vitet 1855-1856, në një kohë që fotografia ishte shpikur. Është e mundur që

fotografitë e arnautëve të jenë bërë në Paris dhe të kenë shërbyer për tu frymëzuar në tablotë e tij orientale, tablo të cilat ai i paraqiti pas kthimit të tij nga Egjipti. Duket se kostumi i pikturuar nga Gérôme është ngacmuar nga fotografia e botuar në klishe 64, të librit Illustration de l'Histoire des Otomans, të Antoine Laurent Castellan dhe Louis Mathieu Lagles (botuar si version i parë) që në vitin 1812 (Musée de l'Homme)..."

Tablotë e Gérôme filluan të vlerësoheshin në Sallonin e Piktorës që hapej çdo vit. Për sallonin e vitit 1859, Charles Baudelaire që kishte parë tablotë e Gérôme me arnautët e tij, shkruante se "Është e pamundur të mos njohësh te zoti Gérôme cilësitë e tij fisnike, ku vlerat e para janë kërkimi i së resë dhe shija për subjektet e mëdha...". Një vit më vonë, për tablotë e Gérôme në sallonin e piktorës, Maxime Du Camp, që e njihje mirë temën orientale, shkruante se "Gérôme na jep provën e një force të respektueshme... ai na dëshmon se po krijon një krijimtari të veçantë me vlera të mëdha..."

Në vitin 1862, Jean-Léon Gérôme do ndërmerre përsëri një udhëtim drejt Egjiptit dhe padyshim takimet e para do ishin me drogmanët, me këta shoqërues-përkthyes, që jo rrallë ishin shqiptarë. Gérôme nuk shkruan gjë për drogmanin e tij të këtij udhëtimi, por ai mund të ketë qenë edhe shqiptar, siç pohonin dhe udhëtarë të tjerë që udhëtonin në Egjipt. Ja çfarë shkruante Frédéric de Carcy, më 1873: "Sapo anijet hedhin spirancat, drogmanët, këta aventurierë me origjinë të ndryshme, disa prej të cilëve nga vendet e Europës dhe shumica nga Malta, u paraqiten udhëtarëve duke u ofruar shërbimet e tyre. Një drogman me kostum shqiptar, i pajisur me rekomandime të ndryshme pak a shumë autentike, na propozoi të na shërbejë. Pranaj, meqë nuk i njoh gjuhët e këtij vendi dhe që nga ky çast, unë vihem në dorën e tyre..."

Pra, Gérôme niset sërish. Udhëtimi drejt këtyre vendeve ekzotike, ishte kthyer jo vetëm në një pasion të vazhdueshëm, por dhe në një frymëzim krijues për personazhe e imazhe që bënin përshtypje të veçantë në sallonet parisiane. Në ditarin e tij, për këtë udhëtim, ai shkruante: "Ndërmora një udhëtim tjetër në Orient, Palestinë, Egjipt e Siri. Ishte hera e parë që ndërmerra një aventurë nëpër shkretëtirë: karvani ynë ishte i organizuar mirë edhe pse i pakët në numër, por ne ishim furnizuar me kujdes me të gjitha gjërat e nevojshme, për të ekzistuar; veçanërisht me ujë e Nilit, pasi për katër kuajt na duhej ta merrnim ujë me vete në kurriz të deveve, meqë kafshët pinin 24 litra ujë në ditë... S'kishte asgjë më të kënaqshme e poetike, sa ngritja e kampit gjatë rrugës, duke i shtuar kësaj dhe kureshtjen ndaj të bukurës dhe të panjohurës. Edhe pse të lodhur nga udha e gjatë, unë i vitesha punës me vrull, sapo arrinim në vendin ku duhej të ndalnim dhe të çlodheshim. Por mjerisht, gjithçka që përjetuam ka mbetur veç në kujtesë. E megjithatë, më mirë këto tri penelata me ngjyra në tela, sesa kujtimet më të bukura..."

Përsëri në Kajro. Por kësaj radhe, Gérôme nuk e gjeti Soliman Pashën, «alias» koloneli Sève i ushtrisë së Bonapartit, i cili e kishte pritur dhe strehuar në një nga shtëpitë e tij në Kajro, gjatë udhëtimit të tij të parë, bashkë me Bartholdi-n dhe të tjerë. Në pushtet ishte Said Pasha, të cilin që në adoleshencë të tij, Mehmet Ali Pasha e kishte dërguar në një shkollë ushtarake në Paris dhe ai ishte një frankofon me kulturë europiane. Madje, ishte ai që i dha të drejtën e koncesionit inxhinierit francez Ferdinand Lesseps, që ai të fillonte punimet për hapjen e kanalit të Suezit. Tashmë, varri i kolonelit Sève gjendej në një turbe të bukur në Rhoda Isles, të Kajros. Nga ky personazh, gjithçka që përjetuam ka mbetur tike, pasi te ai, të gjithë francezët që vinin për studime apo për të ndihmuar në ripërtëritjen e Egjiptit, gjenin një mbështetje të madhe. Sève i ishte shfaqur Mehmet Aliut, në vitin 1819, me një letër të kontit Ségur, meqë ai i kishte kërkuar oficerë të përgatitur, për të reformuar ushtrinë e re të Egjiptit. Atje dhe ishte konvertuar në mysliman, ku ishte martuar me një greke, që ia kishte rrëmbyer një tregtar, në Peloponez.

Artur Rembo, një emër i jashtëzakonshëm

## ADOLESHENTI I PERJETSHEM I VARGJEVE

Njëzet vjeç, pra, hoqi dorë nga poezia. Pastaj iu drejtua vetëshkatërrimit. Thamë, braktisi çka kishte arritur poetikisht dhe preferoi të bënte atë "udhëtimin" e madh... Ashtu si Marko Polo, u bë pastaj udhëtar i botës

Grigor JOVANI

Zhan Nikola Artur Rembo, siç është emri i tij i plotë, rregjistruar së pari në gjendjen civile të qytetës periferike Sarvil, mes pyjeve të famshme të Sardenjës në perëndim të Francës, kufi me Belgjikën, arriti një rekord të papërsëritshëm në botën e poetëve: Iu deshën vetëm 20 vitet e para të jetës për të arritur në panteonin e mbretëshesës së letrave, Poezisë. Pastaj heshti. Thonë se heshtja është pjesë e munit (dhe e veprës) së tij. E cilësuan "heshtja e tij shurdhuese".

Dhe jo vetëm kaq, nuk u bë thjesht "kryqtar" legjendar i saj, por udhëheqës. Përfaqësuesi i parë dhe i përhershëm i simbolizmit në poezinë frënge, është njëkohësisht një nga themelartët e poezisë moderne në botë.

Do të kërkonim më kot një mal veprash nëpër biblioteka, kur do të doni të ndriçoheni me veprën e tij. Dy janë ato, të vetme, dy llambushka të vogla vargësh kryengritëse, por që patën shkëlqimin e një dielli të madh, atij talenti të jashtëzakonshëm poetik me emrin Rembo.

Nga dy vëllimet e tij poetike, "Shkëndijime" (Illuminations, 1873-75) dhe "Një Epokë në Skëterrë" (Une Saison en Enfer, 1873) vetëm i dyti është një libër i tij i ndërgjegjshëm, që u botua me vullnetin e poetit të ri.

Libra të tjerë të pastajmë, të cilat panë dhe vazhdojnë të shikojnë edhe sot ditën e botimit, sa që gjallë por edhe kur u

amëshua, ishin dhe janë vullneti i të tjerëve. U botuan pa dijeni të autorit. Thjesht ngaqë ai ishte larguar nga kjo jetë tepër herët, për të gëzuar atë të përjetshmen, poezinë. Askush nuk protestoi për këtë. E drejta e tij dhe e drejta e tyre. Arti, sikundër dielli dhe yjet përreth tij, ndriçojnë gjithë botën dhe të gjithë të ndriçuarit prej tyre... "kanë njësoj të drejta mbi to".

Njëzet vjeç, pra, hoqi dorë nga poezia. Pastaj iu drejtua vetëshkatërrimit. Thamë, braktisi çka kishte arritur poetikisht dhe preferoi të bënte atë "udhëtimin" e madh... Ashtu si Marko Polo, u bë pastaj udhëtar i botës. Shëtiti dhe jetoj qytetet më të zhurmshme evropiane, njohu kontinente të tjerë, u ngul më së shumti në veri të Afrikës, punoi në gjithfarë punërash. Pa e ditur as vetë, Poezia e ndiqte besnikërisht nga pas. Poezia nuk i harron kurrë dishepujt e saj të mëdhenj. Nuk e shoi kurrë yllin e tij poetik në qiellin e saj të përbotshëm dhe të përjetshëm.

Dhe atëhere kur Parisi, në mungesë të poetit udhëtar, po i përkulej gjithë habi dhe admirim veprës së tij të jashtëzakonshme, ai... i inoroi të gjitha edhe u largua i heshtur nga jeta. Kishte kohë që nuk i nevojitej më.

Rezymeja: 20 vjet jetë poetike dhe dy libra të përjetshëm - ose 1 libër i plotë dhe tjetri me... "korrespondencë". Kaq i mjaftoi ARTUR REMBO-së për të hyrë si poet te përjetësia.



Qasje

## DANTE DHE ISLAMI!

Tashmë është e vërtetuar se Dante Alighieri ishte ndikuar nga burimet myslimane. Problemi nuk është se ai i kishte afuar këto burime, por si i mbërritën atij

Umberto ECO

Në vitin 1919, Miguel Asín Palacios botoi një libër ("Eskatologji myslimane të 'Komedia Hyjnore'"), që shkaktoi shumë zhurmë. Në qindra faqe shiheshin analogji befasuese, mes tekstit të Dantes dhe teksteve të ndryshme të traditës islamike, veçanërisht versionet e ndryshme të udhëtimit natën, të Muhamedit në Ferr dhe Parajsë. Në Itali, lindi një polemikë mes mbështetësve të studimit dhe mbrojtësve të origjinalitetit të Dantes. Po përgatitej 600-vjetori i vdekjes së poetit më të madh italian dhe bota islamike shihej përgjithësisht në klimën e ambicieve koloniale dhe "civilizuese": si mund të mendohej se gjeniu italian të ishte borxhli i traditave të lypsarëve të huaj?

Më kujtohet se në fund të viteve 1980 në Bolonjë organizuam një sërë seminaresh për interpretuesit delirues të Dantes dhe kur doli një libër ("Ideja e deformuar") esetë merreshin me Rosetin (Rossetti), Aronë (Aroux), Valin (Valli), Guenonin (Guénon) dhe me Paskolin e mirë (Pascoli), të gjithë këta, të bashkuar si interpretues ekcesivë ose paranojakë, ose ekstravagantë të poetit hyjnor. U diskutua nëse Asín Palacios i duhet të futet në këtë listë të ekscentrikëve. U vendos që të mos e futnin, sepse tashmë


shumë studime kishin vendosur që Palaciosi, mbase ka qenë ekcesiv, por jo delirues.

Tashmë është e vërtetuar se Dante Alighieri ishte ndikuar nga burimet myslimane. Problemi nuk është se ai i kishte afuar këto burime, por si i mbërritën atij. Mund të fillojmë me shumë vizione mesjetare ku flitet për vizita në mbretëritë e përtejshme. Këto janë: Jeta e Shën Makario romakut, Udhëtimi i tre shenjtëve murgjve në parajsën e Tokës, Vizioni i Tugdalo dhe deri të legjenda e Pusit të Shën Patrikut. Burime perëndimore këto, natyrisht, por Palaciosi i krahasonte me traditat islamike, duke treguar se edhe në ato raste vizionarët perëndimorë kishin mësuar diçka nga vizionarët e bregut tjetër të Mesdheut. Por, Palaciosi ende nuk e njihje Librin e shkallës, i gjendur në vitet 1940 të shekullit të kaluar, i përkthyer nga gjuha arabe në atë kastiliane, më pas në latinisht dhe në frëngjishten e vjetër. A mund ta njihje Dante atë histori të udhëtimit të Profetit në jetën e përtejme? Mund të ketë pasur lajme përmes Brunetto Latinit, mësuesit të tij dhe version latinisht i tekstit gjendej te Collectioledana, ku Pjetri i Nderuar, prifti i Klunit, kishte urdhëruar grumbullimin e teksteve arabe-filozofike dhe shkencore - të gjitha këto para lindjes së Dantes. Maria

Corti ishte përpjekur që ta njihje praninë e këtyre burimeve myslimane në veprën e Dantes. Kush dëshiron sot të lexojë, të paktën një përmbledhje të aventurës së jetës së përtejshme të Profetit, e gjen tek Udhëtimi i natës dhe ngjitja e profetit të Einaudit.

Njohja e këtyre ndikimeve nuk ia heq madhësinë Dantes, përkundër respektit të kundërshtarëve të vjetër të Palacios. Shumë autorë të mëdhenj u kushuan vëmendje traditave letrare pararendësve, p.sh. Ariosto dhe megjithatë ngjizën një vepër shumë origjinale. I solla këto polemikë edhe zbulime, sepse një shtëpi botuese, "Luini", e ribotoi librin e Palacios, me titull më nxitës, "Dante dhe Islami" dhe si parathënie të bukur ka shkruar që Carlo Osola e kishte bërë për përkthimin e vitit 1993.

A ka ende kuptim ta lexosh këtë libër, pasi shumë studime, në pjesën më të madhe i dhanë të drejtë? Po, ka, sepse është shkruar këndshëm dhe paraqet një mori të ballafaqimeve mes Dantes dhe "pararendësve" arabë. Dhe ka kuptim në ditët tona, kur të turbulluar nga barbaritë e marra të fundamentalistëve muslimanë, ka ca prirje që të harrohen lidhjet midis kulturës perëndimore dhe kulturës progresive dhe shumë të pasur islamike të shekujve të shkuar. (Përktheu: Arjan Kallço)



# IMAGJINATA, E VETMJA VALIXHE

Që nga fillimi, letërsia për mua s'ishte autobiografi, por udhëtim për në jetë të tjera, mundësi të tjera

Elif SHAFAK

Fillova të shkruaj letërsi në moshën tetëvjeçare. Një ditë nëna solli në shtëpi një fletore dhe më pyeti nëse më dukej ide tërheqëse të mbaja një ditar personal. Kur hedh vështrimin prapa, mendoj se ajo ishte pak e shqetësuar për gjendjen time mendore. Vazhdimisht tregoja histori në shtëpi, diçka e mirë, por ua tregoja edhe miqve imagjinarë përreth meje, diçka jo edhe aq e mirë. Isha fëmijë i mbyllur deri në atë pikë, sa komunikojta me lapsat me ngjyra dhe u kërkova falje objekteve kur përplasesha me to. Kështu nëna mendoj se ishte gjë e mirë nëse shkruaja për përvojat dhe emocionet e përditshme. Ajo s'e dinte se mendoja që jeta ime ishte jashtëzakonisht e mërzitshme dhe gjëja e fundit që doja të bëja ishte të shkruaja për veten. Përkundrazi, fillova të shkruaj për njerëz të ndryshëm nga unë dhe gjëra që s'më kishin ndodhur kurrë. Kështu filloi pasioni për të shkruar letërsi, i cili vazhdoi gjatë gjithë jetës. Që nga fillimi, letërsia për mua s'ishte autobiografi, por udhëtim për në jetë të tjera, mundësi të tjera. Dhe ju lutem, kini durim, do të vizatoj një rreth dhe do të kthehem në këtë pikë. Por diçka tjetër ka ndodhur gjatë kësaj kohe. Nëna u bë diplomate. Kështu që nga kjo lagje e vogël, paragjykuese, e klasës së mesme të gjyshes, u ngjita vertikalisht në shtresë shoqërore, shkova në një shkollë ndërkombëtare, ku isha e vetmja turke. Aty pata takimin tim



të parë me atë që e quaj "përfaqësuese e së huajës". Në klasën tonë kishte fëmijë nga të gjitha kombësitë. Sidoqoftë, kjo shumëllojshmëri nuk çonte domosdoshmërisht në një demokraci kozmopolite, egalitare. Përkundrazi, krijoi një atmosferë në të cilën secili s'ishi si individ, por si përfaqësuesi i diçkaje më të madhe. Ishim si një miniatyrë e Kombeve të Bashkuara, argëtuese kjo, por sa herë që ndodhte diçka negative në një komb ose fe, fëmija që e përfaqësonte qesëndisej dhe tallej pa fund. Epo, duhej ta kisha ditur, sepse gjatë kohës që isha në atë shkollë në vendin tim ndodhi një grusht shteti, një person me armë i kom-

bësisë sime gati vrau Papën dhe Turqia mori zero pikë në Festivalin European të Këngëve. Herë pas here s'shkoja në shkollë dhe gjatë atyre ditëve ëndërroja të bëhesha marinare. Përjetova për herë të parë domethënien e stereotipave kulturorë. Fëmijët më pyetën për filmin "Ekspressi i mesnatës", të cilin s'e kisha parë. Më pyesnin se sa cigare në ditë pija, sepse mendonin se të gjithë turqit ishin duhanpirës të mëdhenj. Dhe vrisnin mendjen se në cilën moshë do t'i mbuloja flokët. Kam arritur të mësoj se këto ishin tre stereotipat kryesorë për vendin tim: politika, cigarja dhe perçja. Pas Spanjës shkuam në Jordani, Gjermani

ni dhe sërish në Ankara. Kudo ku shkoja, ndieja sikur imagjinata ishte e vetmja valixhe që mund të merrja me vete. Historitë më krijuan ndjenjën e vatrës dhe vijimësisë të cilat më mungonin. Në të njëzetat u shpërngula në Stamboll, në qytetin që adhuroj. Kam jetuar në një lagje shumë të gjallë, të larmishme, vendi ku kam shkruar disa nga romanet. Isha në Stamboll kur u godit nga tërmeti në vitin 1999. Kur vrapova për të dalë jashtë ndërtesës në tre të mëngjesit, pashë diçka që m'u ngulit në kujtesë. Kishim një plak të sertë vendas në lagje, i cili s'ishite alkool dhe s'u fliste pjesëtarëve të grupeve të tjera. Ishte ulur pranë një tranvestiti me parukë të gjatë të zeze dhe bojën e vetullave që i rridhte në faqe. Pashë burrin që hapi një paketë cigaresh me duart që i dridheshin dhe i dha një cigare. Ky ishte imazhi i natës së tërmetit që më ka mbetur në mendje: një shitës dyqani, konservator, dhe një tranvestit që qante, të dy pinin cigare në trotuar. Përballë vdekjes dhe shkatërrimit, dallimet mes tyre u zhdukën dhe të gjithë u bëmë një, për disa orë. Por gjithmonë kam besuar se edhe historitë e rrëfyera kanë efekt të ngjashëm. S'po them që letërsia ka magnitudën e një tërmeti. Por kur po lexojmë një roman të mirë, i lëmë pas apartamentet tona të vogla, të rehatshme, dalim jashtë natën sapo të fillojmë leximin dhe fillojmë të njohim njerëz që s'i kemi takuar kurrë më parë dhe mbase, madje, i kishim paragjykuar.

## Ana tjetër e medaljes

# DYSHIMI

Gjithmonë duhet pasur dyshim nga pak, duhen bërë pyetje, madje, edhe të kundërta me ato që përjetojmë

Nadin GORDIMER

Jam e mendimit se dyshimi është një nga shfaqjet esenciale, prej të cilit në hetojmë gjërat që të gjejmë pakëz të vërtete. Bota është shumë e ndërlikuar: duhen mësuar gratë, njerëzit, fëmijët; duhet studiuar ajo që kanë thënë, madje, edhe kuptimi i lëvizjeve dhe i gjeve të tyre. Ai më nxiti për hulumtime, sepse për shkak të angazhimit, është e rrezikshme të jesh shumë i sigurt dhe të mendosh se e vërteta është plotësisht në anën tonë. Gjithmonë duhet pasur dyshim nga pak, duhen bërë pyetje, madje, edhe të kundërta me ato që përjetojmë. Kjo është një mister, sepse unë kam parë shumë njerëz të guximshëm. Për mua është një enigmë, sepse disa njerëz nga koha në kohë janë tepër kurajoz në jetën politike, por që nuk janë të tillë edhe në raportet vetjake. Kjo ndodh sepse qeniet njerëzore janë plot mangësi, kurse shenjtorët nuk ekzistojnë. Dashuria është shumë, shumë e rëndësishme. Shpesh kam folur dhe kam shkruar se ekzistojnë dy gjëra që vënë në lëvizje njerëzit, të cilave ata nuk mund t'u kundërvihen e që janë forcat kryesore lëvizëse: dashuria dhe politika. Këto janë dy forca të fuqishme. Dashuria gjithmonë është e rëndësishme, ajo është një dukuri joshëse, misterioze. Kur njeriu

kalon moshën, mund të shfaqet një aspekt tjetër i dashurisë që nuk është as tërësisht miqësi, por as tamam dashuri. Kjo është diçka e ndërmjetme. Një miqësi e tillë mund të ekzistojë midis burrit dhe gruas, por që nuk është seksuale, sepse jeta seksuale për të dy vazhdon në jetën private, kurse miqësia e tyre është diçka e veçantë. Jam e bindur se midis qenieve njerëzore kemi një fytyrë tjetër të dashurisë, të cilën ne ende nuk e kemi zbuluar dhe kjo temë më tërheq shumë. Kjo është edhe tema e librit tim të ri... Në çfarëdoj moshe një burrë dhe një grua mund të dashurohen, por kjo dashuri mund të mos mbështetet në marrëdhënien seksuale. Miqtë janë shumë të rëndësishëm për mua, sepse nuk jam e lidhur shumë me familjen. Kjo do të thotë se, krahas fëmijëve të mi dhe burrit, familja ime përbëhet edhe nga miq, të cilët i dua shumë. Ne kemi të njëjtat ide politike. Bashkërisht kemi luftuar dhe kjo ka shumë rëndësi, sepse këto janë lidhje solide. Nuk mund të mbash miqësi me dikë që është racist, sepse është jashtë arsyes. Kam konstatuar se në një familje vëllezërit dhe motrat janë bërë armiq midis tyre për shkak të politikës. Kjo ndodh gjithandëj. Nuk mund të durohet një racist, nëse ju nuk jeni i tillë, gjë që është e kuptueshme.



NUMRI I ARDHSHEM ME 25 DHJETOR

# HEJZA

8 DHJETOR, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000